



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

RAPORTI VJETOR I PUNËS 2021

Prishtinë, 2022

Fjala hyrëse	6
1. Përmbledhje ekzekutive	8
2. Mandati i Akademisë së Drejtësisë.....	9
2.1 Korniza ligjore dhe fuqizimi i Akademisë së Drejtësisë.....	9
2.2 Zhvillimi i bazës ligjore në periudhën raportuese.....	10
2.3 Vështirësitë ligjore që ka hasur Akademia e Drejtësisë në përmbushjen e misionit të saj	10
2.4 Funkcionet dhe kompetencat e Akademisë së Drejtësisë.....	11
3. Organet e Akademisë së Drejtësisë.....	12
3.1 Këshilli Drejtues -Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra.....	12
Aktivitetet e Këshillit Drejtues	13
3.2 Këshilli Programor - Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra	14
Aktivitetet e Këshillit Programor	15
3.3 Organizimi i brendshëm dhe udhëheqja e Akademisë së Drejtësisë.....	15
3.3.1 Drejtori Ekzekutiv – Mandati dhe aktivitetet e ndërmarra.....	16
Aktivitetet e Drejtorit Ekzekutiv	16
3.3.2 Zyra e Programeve Trajnuese- Departamentet e AD-së	17
4. Të arriturat dhe sfidat në zbatimin e Planit të Punës dhe Programin Trajnues Kornizë 2021-2022	17
4.1 Sfidat në zbatimin e programeve trajnuese gjatë vitit 2021	18
4.2 Të arriturat nga aktivitetet në mbështetje të mekanizmave integruar për BE.....	19
4.3 Të arriturat në zbatimin e programit trajnues 2021.....	19
4.4 Krahasimi i punës së Akademisë në tri vitet e fundit	20
4.5 Arritja e objektivave në kuadër të Programeve të Akademisë së Drejtësisë.....	22
4.6 Ngritja e cilësisë së trajnimeve dhe avancimi i metodologjisë trajnuese në programet e Akademisë së Drejtësisë	22
5 Aktivitetet e realizuara sipas programeve të AD-së.....	25
5.1 PROGRAMI I TRAJNIMIT FILLESTAR	26
5.1.1 Të arriturat dhe sfidat sipas objektivave të parapara në Programin e Trajnimit Fillestar dhe Planin e Punës për vitin 2021	26
5.1.2 Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar, gjenerata e VIII (2021-2022).....	26
5.1.3 Realizimi i testit përfundimtar	28
5.2 PROGRAMI PËR TRAJNIME TË VAZHDUESHME	29
5.2.1 Objektivat e Programit për Trajnim të Vazhdueshëm për vitin 2021	29
5.2.2 Aktivitetet trajnuese të zhvilluara në PTV	29

5.2.3 Pjesëmarrja në Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm.....	31
5.2.4 Trajnimet e vazhdueshme sipas fushave	32
5.2.5 Fusha penale (materiale dhe procedurale).....	33
5.2.6 Trajnimet nga fusha Civile (materiale dhe procedurale).....	38
5.2.7 Trajnimet nga Drejtësia për fëmijë – aspekti civil dhe penal.....	39
5.2.8 Trajnimet nga fusha Ekonomike	39
5.2.9 Trajnimet nga fusha Administrative.....	40
5.2.10 Trajnimet nga E Drejta Kushtetuese	40
5.2.11 Trajnimet për Dhomën e Posaçme të Gjykatëse Supreme	40
5.2.12 Trajnimet nga fusha e kundërvajtjeve	41
5.2.13 Trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe BE-së	41
5.2.14 Trajnimet për mosdiskriminimin	42
5.2.15 Trajnimet nga fusha e ndërmjetësimit.....	42
5.2.16 Trajnimet nga kompetenca ndërdisiplinare.....	42
5.2.17 Trajnimet e obligueshme për Etiken profesionale	42
5.2.18 Bashkëpunimi dhe mbështetja e donatorëve në ofrimin e Trajnimeve të Vazhdueshme.....	43
5.3 Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	44
5.4 Trajnimi për profesionet e lira	45
5.5 Trajnimet për Trajnues.....	46
6. MËSIMI NË DISTANCË NËPËRMES PLATFORMËS E-LEARNING	49
7. PROGRAMI PËR HULUMTIME DHE PUBLIKIME (PHP).....	50
7.1. Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese.....	51
7.2 Veprimtaria botuese	51
7.3 Menaxhimi i koleksioneve të bibliotekës së AD-së.....	53
7.4 Qasja në burime ligjore në data bazat ndërkombëtare	53
7.5 Përditësimi i statistikave dhe data bazës së të dhëna me aktivitetet e realizuara gjatë vitit në kuadër të programeve trajnuese të AD-së.....	54
8. BASHKPUNIMI ME DONATORË DHE PROJEKTE NDËRKOMBËTARE - PUNËTORI, TRYEZA PUNE DHE AKTIVITETE TJERA	54
8.1 Aktivitetet e realizuara me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-së OPDAT - Ambasadën Amerikane.....	54
8.2 Aktivitetet e realizuara me Ambasadën Amerikane në Zagreb.....	55
8.3 Aktivitetet e realizuara me programet e USAID.....	55
8.4 Aktivitetet e realizuara me zyrën e Bashkimit Evropian dhe projektet e saj	55

8.6 Aktivitetet e realizuara me zyrën e Këshillit të Evropës dhe projektet e saj.....	56
8.7 Aktivitetet e realizuara me projektin “Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosovë” të financuar nga Ambasada Britanike.....	56
8.8 Aktivitetet e realizuara me OSBE-në.....	56
8.9 Aktivitetet e realizuara me GIZ- “Projekti për Reformë Ligjore dhe Administrative”.....	57
8.10 Aktivitetet e realizuara me UNDP dhe SAEK.....	57
8.11 Aktivitetet e realizuara me UNCHR-Zyra e Misionit në Kosovë.....	58
8.12 Aktivitetet e realizuara me Grupin e bankës botërore, mbështetur nga Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO).....	58
8.13 Aktivitetet e realizuara me Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim-ATRC.....	58
8.14 Aktivitetet e realizuara me EULEX dhe organizatat tjera (IRZ, EIPA, CEL dhe INJECT).....	58
8.15 Aktivitetet me Rrjetin Evropian të Trajnimit Gjyqësor (EJTN).....	59
9. Programi për praktikantë dhe studentë.....	59
10. ADMINISTRATA DHE FINANCAT.....	59
10.1 Shërbimet e përgjithshme.....	60
10.2 Burimet njerëzore.....	60
10.2.1 Numri i punësuarve dhe nevojat për punëtorë të rinj.....	61
10.2.3 Trajnimet e stafit.....	62
10.3 Përmirësimi i infrastrukturës së AD.....	63
10.3.1 Planifikimi për asete të reja dhe ndërtesën e Akademisë.....	64
10.4 Avancimi i teknologjisë informative.....	65
10.5 Prokurimi.....	65
10.6 Financat.....	66
10.7 Mbështetja financiare nga donatorët.....	71
10.8 Asetet.....	72
10.8.1 Asetet e Akademisë.....	72
10.9 Auditimi nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.....	72
Sfidat dhe rekomandimet.....	73
Anekset.....	74

Akronimet

ABEK - Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës

AD – Akademia e Drejtësisë

AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit

ANJF - Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas

DAF – Departamenti i Administratës dhe Financave

DHPGJS-Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

EIFL - Electronic Information for Libraries

EJTN – European Judicial Training Network (Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor)

ENM – L'École Nationale de la Magistrature

GIZ - Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

IGJK – Instituti Gjyqësor i Kosovës

ILIAS – Integriertes Lern – Informations - und Arbeitskooperations-System

KDM – Kodi i Drejtësisë për të Mitur

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPMSHCK – Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

KPPK – Kodi i Procedurës Penale i Kosovës

LMD – Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

OPP - Oda e Përmbaruesve Privat

PHP – Programi për Hulumtime dhe Publikime

PTF – Programi i Trajnimit Fillestar

PTV – Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës

SQEPK-Sistemi qendror i evidencës Penale të Kosovës

TAIEX – Technical Assistance and Information Exchange Instrument

TI – Teknologjia Informative

USAID - The United States Agency for International Development

UNDP-Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

UNHCR-Zyra e Misionit në Kosovë

ZKA – Zyra e Kombëtare e Auditimit

Fjala hyrëse

Akademia e Drejtësisë, përmes këtij raporti shfaq aktivitetet dhe zhvillimet tjera gjatë vitit 2021. Ngjashëm si viti paraparak edhe ky vit karakterizohet me vazhdimin e rrethanave të krijuara nga pandemia COVID 19 dhe si rrjedhojë edhe kufizimet e imponuara. Pavarësisht kësaj situatë ky vit veçohet njëkohësisht edhe i punës së Akademisë së Drejtësisë me intenzitet duke e përmbyllë me shumë aktivitete në të gjitha programet e saj sipas ligjit.

Bazuar në mandatin që buron nga Ligji për Akademinë e Drejtësisë dhe aktet tjera nënligjore, Programin Kornizë 2020-2021, Planin Strategjik 2019-2021 dhe Planin e punës për vitin 2021 u realizuan aktivitete të shumta në funksion të zhvillimit profesional të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve tjerë ligjor.

Viti 2021 karakterizohet një vit me shumë iniciativa që kanë synuar të ndihmojnë AD-në si në përmbushjen e mandatit ligjor të saj ashtu edhe në ofrimin dhe përmbushjen e objektivave trajnuese për përfituesit. Në kuadër të mandatit ligjor të AD-së në bashkëpunim me MD është formuar grupi punues për të hartuar konceptin e ndryshimeve dhe plotësimeve të nevojshme të legjislacionit të AD-së që do të ndihmojë në eliminimin e barrierave dhe vështirësive që janë aktualisht në ushtrimin e kompetencës. Përderisa, reforma për recesionin e agjencive të pavarura e udhëhequr nga MPB, me amandamentet ligjore të dërguara në Qeveri e më pas edhe në Kuvend është propozuar që AD do të trajtohej si Agjenci Ekzekutive në kuadër të MD.

Në objektivat e parapara trajnuese për vitin 2021 duke filluar me kuadrin e trajnimeve fillestare janë realizuar trajnime teorike dhe praktike sipas kurrikulës së këtij programi, për 24 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së VIII.

Në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme janë realizuar trajnime nga të gjitha fushat e së drejtës duke përfshirë aspektin material dhe procedural në kuadër të cilave kanë përfituar gjyqtarë, prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive si dhe profesionistë tjerë ligjor. Vëmendje të veçantë kishin trajnimet të cilat kanë qenë prioritet i gjyqësorit dhe dokumenteve tjera strategjike në vend, si trajnimet e specializuara në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, pastrimit të parave, hetimeve financiare, krimeve kibernetike, ekstremizmit dhe radikalizmit si dhe mashtimin në prokurimin publik. Gjithashtu edhe në parandalimin dhunës në familje dhe dhunës ndaj gruas, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut me fokus te Konveta Evropiane e të Drejtave të njeriut dhe Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në kuadër të Programit për Hulumtime dhe Publikime (PHP) janë realizuar të gjitha aktivitetet e parapara në planin e punës, sikurse vlerësimi i nevojave trajnuese në dobi të hartimit të programeve trajnuese adekuate si dhe aktivitete në fushën e publikimeve. Biblioteka ligjore e Akademisë ka vazhduar të jetë në shërbim të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë varësisht prej kërkesave të përfituesve të saj duke iu ofruar burimet juridike dhe materialet e ndryshme ligjore qoftë nga katalogu i bibliotekës fizike ashtu edhe nga biblioteka elektronike.

Partneriteti dhe bashkëpunimi me donatore vazhdon te mbetet nje nga faktorët kyqe ne performancen e suksesheme te AD. Nga mbështetja e donatoreve 40% e aktiviteteve trajnuese janë realizuar, kështu cilësia dhe ekspertiza qe eshte ofruar prezanton nje vlere te shtuar si ne kuadër te programeve trajnuese ashtu edhe ne veprimtarinë botuese te AD se

Raporti gjithashtu ofron edhe aktivitetet e realizuara me përkrahjen e partnerëve ndërkombëtar, të cilat kanë qenë të orientuara kryesisht në drejtësinë komerciale, në fushën e të drejtave të njeriut si dhe në luftimin e formave të ndryshme të kriminalitetit, luftimin dhe parandalimin e dhunës në familje, politiken ndeshkimore, lirinë shprehjes, përmbardimin privat etj. Mbeshtetja e madhe dhe e vazhdueshme nga organizatat dhe institucioneve ndërkombetare ka mundësuar pjesëmarrjen dhe prezantimin e AD si në forumet e ndryshme ndërkombetare ashtu edhe nismat regjionale, barabart me të gjitha institucionet trajnuese të regjionit. Në vazhdim raporti vjetor i punës përmban edhe të dhëna më të detajuara statistikore për shpenzimet buxhetore dhe aktivitetet e prokurimit në kuadër të Departamentit për Administratë dhe Financa.

Në fund shfrytëzoj rastin që të shpreh falënderimin tim për angazhimin dhe punën profesionale të anëtareve si të Këshillit Drejtues, Këshillit Programor, stafit, me qëllim të zbatimit më efektiv të veprimtarisë së AD-së. Një falënderim të veçantë dëshirojë të shpreh edhe për të gjithë përfituesit, institucionet e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, institucionet tjera vendore, organizatat ndërkombëtare, partnerë, donatorë dhe miq të AD-së, pa mbështetjen e të cilëve rezultatet e arritura gjatë këtij viti nuk do të ishin në nivelin siç janë prezantuar në këtë raport.

Sinqerisht,
Vaton Durguti
Kryetar i Këshillit Drejtues

1. Përmbledhje ekzekutive

Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare e gjyqtarëve dhe prokurorëve duke përfshirë edhe profesionistët tjerë ligjor është obligim ligjor që rezulton nga Ligji nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë. Përmes këtij ligji ky institucion gëzon pavarësinë institucionale dhe funksionale duke qenë autoritet i vetëm dhe kompetent për trajnimin të kuadrit profesional të sistemit gjyqësor dhe sistemit prokurorial, duke përfshi edhe profesionet e lira në disa raste specifike.

Në periudhën raportuese, AD me tërë potencialin e saj është angazhuar në zhvillimin dhe zbatimin e programeve trajnuese sikurse të hartuara bazuar në nevojat trajnuese të përfituesve të saj si dhe ofrimin e burimeve ligjore përfituesve të saj e gjithashtu edhe në zhvillimet në gjyqësor duke i adresuar ato dhe koordinuar me akterët relevantë. Për shkak të pandemisë COVID-19 aktivitetet e planifikuara janë realizuar përmes platformës elektronike dhe në formë të kombinuar për parandalimin e pandemisë dhe në përputhje me rekomandimet e institucioneve përkatëse.

Akademia realizon funksionet ligjore në bazë të tri programeve kryesore si: Programi për Trajnime të Vazhdueshme, Programi për Trajnime Fillestare dhe Programi për Hulumtime dhe Publikime, ndërsa mbështetja administrative dhe finciare realizohet nga Departamenti për Administratë dhe Financa.

Raporti përfshin aktivitetet e raalizuara në kuadrin e trajnimeve fillestare për 24 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së VIII të cilët kanë përfunduar sesionet e trajnimit teorik në dhjetor të këtij viti, ndërkaq janë duke vazhduar sesionet e trajnimit praktik në gjykatat përkatëse ku janë të emëruar nën mbikëqyrjen e mentorit deri në përfundimin e sesioneve konform programit trajnues për këtë gjeneratë e që pritet të përfundohet gjatë muajit mars 2022.

Raporti përfshin aktivitetet e realizuara në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha lëmit e së drejtës, veçanërisht; penale, civile, drejtësisë për fëmijë (aspekti civil dhe penal), administrative, kushtetuese, kundërvajtje, tregtare, ndërkombëtare, të drejtën e Bashkimit Evropian, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, tema e module trajnuese të karakterit interdisiplinar si: etika profesionale, arsyetimi ligjor, menaxhimi, komunikimi dhe trajnime tjera të cilat në raport janë paraqitur në mënyrë të detajuar.

Gjatë periudhës raportuese AD ka organizuar trajnime për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive si dhe është fokusuar në zhvillimin e kurrikulës trajnuese veçanërisht për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive. Në kuadër të kësaj kurrikule përfshihen modulet e trajnimit bazik në fushën penale dhe civile duke përfshirë aspektin material dhe procedural, politikën ndëshkimore dhe sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë, e cila pritet të zbatohet gjatë vitit 2022.

Raporti përfshinë edhe aktivitetet tjera dedikuar profesionisteve tjerë duke përfshirë përmbaruesit privat, zyrtarët të ANJF, avokatet shtetërore, administratoret falimentues etj.

Në raport janë paraqitur edhe aktivitetet e nederrmarra në pregaditjen e kuadrit për implementimin e ligjit për gjykatën komerciale, ku tashme AD në bashkëpunim me Projektin e USAID për Drejtësinë Komerciale ka zhvilluar kurrikulen trajnuese dhe ka pregaditur 17 trajner që do të trajnojnë gjyqtarët që pritet të emrohen në gjykatën e ardhshme komerciale të Kosovës.

Me prioritet të veçantë ishte edhe veprimtaria botuese dhe ofrimi i burimeve ligjore për përfituesit e AD-së nga resurset me të cilat ka disponuar biblioteka ligjore si dhe qasja në platformat elektronike me burime ligjore ndërkombëtare përmes ABEK.

Si çdo vit, edhe gjatë vitit 2021 Akademia ka marrë pjesë në konferenca e takime regjionale e ndërkombëtare, të cilat për shkak të pandemisë kryesisht ishin online. Poashtu, Akademia ka mundësuar pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në aktivitete të cilat për qëllim kishin zhvillimin profesional të tyre.

Në raport janë të përfshira edhe aktivitetet me donatorë dhe partnerë tjerë të cilët me ekspertizat e tyre ndërkombëtare kanë promovuar praktikat më të mira në luftimin dhe parandalimin e formave të ndryshme të kriminalitetit. Gjithashtu raporti përmbanë edhe aktivitetet nga veprimtaria administrative dhe financiare, të cilat me potencialin e tyre kanë qenë të angazhuara në menaxhimin dhe ekzekutimin adekuat të buxhetit të Akademisë së Drejtësisë.

Pavarësisht mungesave në staf dhe sfidave të paraqitura gjatë vitit 2021, Akademia është angazhuar maksimalisht në zbatimin e mandatit ligjor dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara në mbështetje të ndërtimit të një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe profesional.

2. Mandati i Akademisë së Drejtësisë

Akademia e Drejtësisë është institucion publik, i pavarur cili është në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe sipas kërkesave dhe mundësive edhe për profesionet e lira. Akademia e Drejtësisë këtë funksion e realizon përmes zhvillimit dhe zbatimit të programeve trajnuese dhe burimeve ligjore në përputhje me nevojat adekuate për trajnime të cilat identifikohen nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese.. Akademia e Drejtësisë kryen edhe analiza, hulumtime si dhe kryen veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve tjera të lira.

- **Misioni**

Të ofrojë trajnim cilësor gjyqësor për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në gjyqësor, analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese, në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet më të mira të njohura ndërkombëtarisht.

- **Vizioni**

Të shërbejë si institucion modern i të mësuarit, i përshtatur ndaj dinamikës së përgjithshme të zhvillimit, kontribues kryesor për një gjyqësor të paanshëm, të pavarur dhe profesional që gëzon besimin e publikut.

2.1 Korniza ligjore dhe fuqizimi i Akademisë së Drejtësisë

Akademia e Drejtësisë veprimtarinë e saj e ushtron duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-095 për AD-në si dhe aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, dhe atë si në vijim:

- Rregullore Nr. 01/2017, për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 02/2017, për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 03/2017, për Trajnimin Fillestar;
- Rregullore Nr. 04/2017, për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 05/2017, për Tarifat e Trajnimeve për Avokat Shtetëror, Avokatë dhe Profesionet e Tjera të Lira;
- Rregullore Nr. 06/2017, për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr. 08/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr.01/2018, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë.
- Rregullorja Nr. 02/2019 - për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë
- Rregullorja Nr. 01/2019 - për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 01/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Akademinë e Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 01/2020, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar.

2.2 Zhvillimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Në vazhden e avancimit të legjislacionit të AD-së, në periudhën raportuese organet e AD janë angazhuar në plotësim ndryshimin e dy rregulloreve, Rregulloren për Trajnim Fillestar dhe plotësim ndryshimin e Rregullores nr. 02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët. Plotesim ndryshimi i Rregullorese se PTF ka rezultuar me organizimin me efikas të trajnimit fillestar, ngritjen e pragut kalues në testet perfundimtare. Ndërsa, Rregullorja per Trajnuesit dhe Mentorët synon ngritjen e profesionalizimit në ofrimin e trajnimeve përmes fuqizimit edhe më tej të kriterëve të përzgjedhjes së trajnuesve dhe mentorëve, ngritjen e transparences dhe llogaridhenjes se trajnerëve si dhe çështjet tjera me rëndësi sa i përket programeve trajnuese që ofron AD për përfituesit e saj sipas ligjit. Rregullorja është në proces të finalizimit dhe sapo të të adresoj gjitha çështjet që pritet t'i përfshijë do të hyjë për zbatim në fillim të vitit 2022.

2.3 Vështirësitë ligjore që ka hasur Akademia e Drejtësisë në përmbushjen e misionit të saj

Permbushja e mandatit ligjor të AD varet në zbatimin e ligjshëm të funksioneve të përcaktuara me Ligjin për AD-në, e që në praktiken e deritashme është dëshmuar mungesa e disa akteve nënligjore që pengojnë funksionalizimin e plotë të AD konform ligjit. Gjatë zbatimit të Ligjit të AD-së në praktikë janë detektuar mangësi të theksuara veçanërisht në aspektin e trajnimeve si ato fillestare ashtu edhe të vazhdueshme. Veprimtaria hulumtuese dhe botuese e AD pothuajse nuk është e rregulluar fare. Mungesa e akteve nënligjore kanë pamundësuar publikimin e revistave shkencore të AD-së “Justicia “ dhe “Opinion Juris” .

Andaj me datë 25 qershor 2021 sipas kërkesës së AD-së , MD themelon grupin punues per hartimin e koncept dokumentit te perbere nga 17 antare, njeherit përfaqësues të të gjithë aktereve kryesore ne trajtimin e çështjeve ligjore qe do te adresohen ne koncept dokument. Në grup punues janë të

përfaqësuar të gjitha institucionet relevante si AD, KGJK, KPK , MD , Shoqeria Civile si dhe ekspertet nderkombetare nga EUKOJUST dhe OPDAT.

Gjithashtu, nisma e Qeverise që me ligjin për recesionin e agjencive të pavarura ka tentuar që të ndryshoj statusin juridik të Akademisë së Drejtësisë, mirëpo që një solucion me të qëndrueshëm nuk ka pasur. Statusi aktual që e ka Akademia, është organ i themeluar nga Kuvendi dhe që i raporton Kuvendit, përkatësisht Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit (Komisionit për Legjislacion). Disa nga tentativat e fundit përfshijnë edhe kalimin e Akademisë së Drejtësisë si Agjenci ekzekutive e Ministrisë së Drejtësisë. Po ashtu ka pasur edhe propozime dhe ide që e njëjta të vendoset nën “menaxhim” të dy këshillave, respektivisht Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial .

Përkundër procesit për rishikimin funksional dhe tendencat për organizimin ndryshe nga këto siq u tha më lartë Akademia e Drejtësisë ka vazhduar aktivitetet dhe angazhimet e saj në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve dhe komunitetit tjetër ligjor duke ofruar trajnime për çështjet më sfiduese të sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe duke ofruar praktikat më të mira dhe standardet evropiane.


2.4 Funkcionet dhe kompetencat e Akademisë së Drejtësisë

Bazuar në kompetencat që përcakton ligji, Akademia e Drejtësisë kryen funksionet e parapara si në vijim:

- a. harton programet e trajnimit dhe organizon trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- b. zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime përmes mekanizmave të përcaktuara nga Akademia, dhe në bazë të kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (më tej: KGJK), Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej: KPK).
- c. organizon trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, pas koordinimit paraprak të nevojave për trajnime me KGJK-në dhe KPK-në, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- d. mund të organizojë trajnime të vazhdueshme profesionale për avokat shtetëror, avokat, noter, përmbarues privat, ndërmjetësues, administratorët falimentues, si dhe profesione tjera në bazë të vlerësimeve të Akademisë, sipas kërkesave të institucioneve kompetente;
- e. zhvillon dhe realizon programet e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në, Odat e profesioneve të lira apo institucionet përkatëse;
- f. mbanë të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në Akademi në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- g. vendosë dhe mbanë bashkëpunim me institucionet vendore dhe institucionet e huaja të ngjashme lidhur me punët të cilat i kryen, duke përfshirë praktikat profesionale dhe programet e shkëmbimit;
- h. kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore;
- i. kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira;
- j. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të Akademisë.

3. Organet e Akademisë së Drejtësisë

Kompetencat dhe funksionin e saj AD i kryen përmes organeve kryesore të saj si Këshilli Drejtues, Këshilli Programor dhe Drejtori Ekzekutiv.



Grafikoni nr. 1

3.1 Këshilli Drejtues -Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra

Këshilli Drejtues i Akademisë përbëhet nga nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy (2) janë anëtarë ex officio, ndërsa shtatë (7) anëtarë nga institucionet e mëposhtme:

Anëtarë ex officio janë Kryetari i Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurori i Shtetit. Anëtarët tjerë janë:

- 3 (tre) anëtar të emëruar nga KGJK dhe atë, një (1) gjyqtar nga Gjykata Themelore, një (1) nga Gjykata e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KGJK-së;
- 3 (tre) anëtar të emëruar nga KPK dhe atë, një (1) prokuror nga Prokuroria Themelore, një (1) nga Prokuroria e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KPK-së;
- 1 (një) anëtarë i emëruar nga Ministria e Drejtësisë;

Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen në kohëzgjatje prej katër (4) vite, pa mundësi rizgjedhje edhe për një mandat.

Sipas ligjit, Këshilli Drejtues i Akademisë ka kompetencë për:

- Miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj;
- Miratimin e projektbuxhetit të Akademisë;
- Miratimin e strategjisë zhvillimore, planit të punës së Akademisë dhe programit të trajnimeve;

- d. Miratimin e listës së trajnerëve dhe mentorëve;
- e. Mbikëqyrjen e punës së Akademisë;
- f. Përcaktimin e prioriteteve në ofrimin e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- g. Zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit Ekzekutiv;
- h. Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Programor;
- i. Kryerjen e punëve tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore;

Aktivitetet e Këshillit Drejtues

Gjatë vitit 2021, Këshilli Drejtues ka ushtruar me sukses mbykqyrjen e punës së AD së, nëpërmes vendimeve ka avancuar punën e AD dhe organeve të saj, ka ndihmuar në rritjen e performances dhe rritjen e llogaridhenjes së organeve të AD-së. Gjithashtu nga KD, kater anetare janë zëvendësuar, ka vendosur dhe ka emeruar gjashte anëtare të rinje të Këshillit Programor, ka diskutuar dhe ka aprovuar programet trajnuese, raportin vjetor të punës, planin e punës së AD-së, dhe ka vendosur ne lidhje me propozimet dhe rekomandimet për mentor. Pra , gjate vitit janë mbajtur gjashtë (6) takime të rregullta. Në këto takime ka debatuar dhe vendosur për çështje të ndryshme që ndërlidhen me punën dhe aktivitetet e AD-së.

Në mbledhjet e rregullta, Këshilli Drejtues ka marrë vendime dhe ka miratuar aktet si në vijim:

1. Rregulloren Nr.01/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.03/2017 për Trajnimin Fillestar;
2. Vendim për parandalimin e konfliktit të interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, për anëtarët e Këshillit Drejtues dhe anëtarët e Këshillit Programor të AD –së njëkohësisht edhe në ushtrimin e funksionit të trajnuesit të AD-së ;
3. Miraton kërkesën e gjyqtarëve të trajnimit fillestar (gjenerata e VIII-të) për vijimin e trajnimit fillestar në formë fizike në Akademinë e Drejtësisë, duke i respektuar njëkohësisht të gjitha masat për mbrojtje nga pandemia COVID19, të cilat janë në fuqi me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
4. Miraton propozimin e Komisionit për Çështje Normative të Akademisë së Drejtësisë për rregullimin e statusit të të punësuarve në Akademinë e Drejtësisë, përshtatshmërisht me statusin e të punësuarve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës respektivisht të punësuarve në administratën Sekretariateve te këshillave ne fjalë
5. Miraton Planin e Punës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2021;
6. Miraton dorëheqjen unanime të anëtarëve të Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
7. Miraton Kërkesën Buxhetore 2022-2024 të Akademisë së Drejtësisë;
8. Miraton propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për mentor në lëmin civile, z. Hajrullah Aruqi, gjyqtar në Gjykatën Themelore Mitrovicë - dega Skenderaj, për gjyqtarin me mandat fillestar Arnis Dumani në Gjykatën Themelore Mitrovicë - dega Skenderaj;
9. Miraton propozimin për organizmin e tri (3) moduleve të trajnimit fillestar përkatësisht 12 sesione trajnues për gjyqtarin me mandat fillestar z. Taulant Rexhbeqaj, i cili i është bashkuar trajnimit fillestar me një (1) muaj vonesë, respektivisht pas dekretimit te veçantë nga Presidenca;

10. Miraton rekomandimet nga raporti për vlerësimin e ndërtesës së re të Akademisë së Drejtësisë në aspektin e nevojave për hapësirë dhe funksionalitet lidhur me infrastrukturën e TIK, i hartuar nga ekspertët e Projektit EUKOJUST për një organizim më funksional dhe shfrytëzim më të mirë të hapësirës së objektit;
11. Miraton propozimin e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, që pozita e paraparë e Koordinatorit të Programeve Trajnuese të AD-së sikurse e paraparë me organizimin e mbrendshëm dhe organogramin e AD, të konvertohet në pozitën e Udhëheqësit të Programit Trajnues për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive;
12. Miraton kërkesën e z. Enver Peci, Kryetar i Gjykatës Supreme, për dorëheqje nga detyra e Kryesuesit të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
13. Zgjedhë z. Vatton Durguti, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit, Kryesues të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
14. Refuzon si të pabazuar ankesën e Rrezarta Lleshajt nr.353 e datës 23.09.2021 gjyqtare e sapoemëruar - vijuese e Programit për Trajnim Fillestar (PTF-së) e gjeneratës së VIII në Akademinë e Drejtësisë, dhe miraton rekomandimin e datës 07 tetor 2021 të Komisionit të Ankesave për Vlerësim në PTF të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me 07 tetor 2021 për këtë çështje;
15. Miraton dorëheqjen e znj. Saranda Çunaku, ish anëtare e Këshillit Drejtues nga radha e Ministrisë së Drejtësisë;
16. Pas shqyrtimit të kandidateve në listën e të nominuarve nga gjykatat dhe prokuroritë përkatëse, përmes procedurës së votimit të hapët dhe njëzëri u krijua përbërja e re Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
17. Miraton Planin e Punës dhe Performancës për vitin 2022;
18. Shqyron dhe miraton Rekomandimet/Propozimet e Këshillit Programor për Programin Trajnues për vitin 2022;
19. Diskuton dhe miraton Programin Trajnues për vitin 2022;
20. Shqyrton kërkesën e KGJK për mbështetjen e Këshillit Gjyqësor nga AD për shtypjen/printimin e një sasive të ligjeve.

3.2 Këshilli Programor - Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra

Këshilli Programor është organ ndihmës profesional i cili angazhohet për hartimin e Programit të Trajnimeve dhe për të siguruar cilësi për trajnimet e ofruara nga Akademia e Drejtësisë. Funkcionet kryesore të Këshillit Programor janë:

- Hartimi i propozim programit të trajnimeve të Akademisë në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- Përcjellja e realizimit të programeve dhe sukseseve të tyre;
- Të jap orientime për avancimin e metodave dhe teknikave trajnuese, pavarësisht dhe në bashkëpunim me trajnuesit dhe mentorët;
- Të jap mendim për listën e trajnuesve dhe mentorëve;
- Të jap këshilla propozime dhe sygjerrime, organeve të Akademisë për përmirësimin e kualitetit të trajnimeve;
- Kryejnë edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe akte nënligjore të Akademisë.

Këshilli Programor përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, të cilët i emëron Këshilli Drejtues, nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit dhe ekspertëve tjerë. Mandati i anëtarëve të Këshillit Programor, me përjashtim të Drejtorit Ekzekutiv, është katër (4) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Kryesuesi i Këshillit Programor është ex officio Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.

Aktivitetet e Këshillit Programor

Gjatë vitit 2021 Këshilli Programor ka mbajtur dy (2) takime. Në takimin e parë si pikë kryesore ishte diskutimi për zbatimin e vendimit të Këshillit Drejtues për parandalimin e konfliktit të interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik për anëtarët e Këshillit Drejtues dhe anëtarët e Këshillit Programor të AD –së. Me rastin e këtij takimi anëtarëve të Këshillit Programor iu është ofruar mundësia që të deklarohen se a do të mbajnë funksionin e anëtarit të KP apo do zgjedhin që të jenë trajnues në Akademinë e Drejtësisë. Me qëllim parandalimin e konfliktit të interesit unanimisht gjithë anëtarët që ishin njëkohësisht edhe trajnues kanë ofruar dorëheqje nga pozita e anëtarit të Këshillit Programor të AD-së.

Takimi i dytë i Këshillit Programor është realizuar pas konsolidimit të përbërjes së re të këtij organi. Pikë kryesore e këtij takimi përveq njoftimit për detyrat dhe përgjegjësitë e këtij organi ishte diskutimi dhe shqyrtimi i draft Programit Trajnues për vitin 2022. Me rastin e këtij takimi është shqyrtuar përmbajtja e trajnimit, struktura, temat e përfshira në Programin Trajnues 2022, metodologjia e realizimit të trajnimeve, kohëzgjatja e sesioneve të trajnimit, si dhe çështje tjera të rëndësishme për zbatimin e këtij programi trajnues. Këshilli Programor përveç rishikimit të draft-Programit Trajnues për vitin 2022, ka ofruar edhe rekomandimet e tij, të cilat në vijim janë prezantuar para Këshillit Drejtues të AD-së për diskutim dhe miratim në takimin e radhës.

3.3 Organizimi i brendshëm dhe udhëheqja e Akademisë së Drejtësisë

Në kuadrin e Akademisë së Drejtësisë janë të punësuar 27 zyrtarë duke përfshirë edhe Drejtorin Ekzekutiv ndërkaqjanë të lejuara gjithësejt 32 pozita. Në periudhën raportuese nuk është zhvilluar asnjë procedurë e rekrutimit për pozitat e lira për shkak të ndryshimeve legislative përkatësisht Ligji për zyrtarët publik por edhe nismat për ndryshimin e Ligjit për AD-në.

Organizimi i brendshëm është i rregulluar me Rregulloren Nr.01/2018, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë, ku sipas kësaj rregulloreje, Akademia e Drejtësisë është e ndarë në katër departamente dhe zyrën e programeve trajnuese.

Bazuar në aktin për organizimin e brendshëm¹, Akademia e Drejtësisë funksionon dhe është e organizuar me këtë strukturë:

- Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;
- Departamenti për Trajnim Fillestar, Departamenti për Trajnim të Vazhdueshëm, Departamenti për Hulumtime dhe Publikime si dhe

¹ Rregullorja nr. 01/2018 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Akademi të Drejtësisë.

- Departamenti për Administratë dhe Financa

3.3.1 Drejtori Ekzekutiv – Mandati dhe aktivitetet e ndërmarra

Bazua në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, Drejtori Ekzekutiv bën pjesë në kategorinë e Zyrtarëve të Lartë Drejtues. Gjatë vitit 2021 është fokusuar në realizimin e aktiviteteve si në vijim:

- Përfaqësimin e Akademisë para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
- Menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë;
- Zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues;
- Propozimin e projektbuxhetit vjetor të Akademisë;
- Propozimin e Planit të Punës dhe Performancës për vitin 2022 dhe Programin e Trajnimeve për vitin 2022;
- Propozimin e listës së trajnuesve për miratim nga Këshilli Drejtues;
- Menaxhimin me mjetet financiare dhe pronën e Akademisë;
- Përgatitjen e raporteve të rregullta vjetore dhe raporteve tjera sipas kërkesave të Këshillit Drejtues.

Aktivitetet e Drejtorit Ekzekutiv

Gjatë periudhës raportuese Drejtori Ekzekutiv, ka ushtruar me sukses dhe kompetencë detyrat konform ligjit dhe objektivave si të përcaktuara në planin e punës. Në ushtrimin e kompetencës së përfaqësimit të AD-së para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare ka realizuar gjithësejt 241 takime. Me qëllim të funksionimit të plotë dhe më të mirë të Akademisë së Drejtësisë, zyra e Drejtorit ka realizuar aktivitete të shumta koordinuese me KGJK dhe KPK, Ministrinë e Drejtësisë si dhe me partnerë ndërkombëtarë, përkatësisht me përfaqësues të projekteve me donatorev të ndryshëm. Gjithashtu vëmendje të veçantë kanë pasur edhe takimet me, kryetarë të gjykatave, kryeprokurorë të prokurorive si dhe me trajnues të cilët kanë qenë pjesë e zbatimit të programeve trajnuese në pajtim me kërkesat dhe nevojat për trajnim.

Përkundër gjendjes pandemike e cila ka vazhduar edhe gjatë periudhës raportuese në masat e përcaktuara për prandalim ka zhvilluar një numër të konsiderueshëm të takimeve të cilat kishin në fokus zhvillimin dhe avancimin e moduleve trajnuese, krijimin e burimeve të reja, përkatësisht doracakëve, udhëzuesve për gjyqtarë dhe prokurorë si dhe profesionistëve tjerë ligjor.

Në periudhën raportuese është vazhduar bashkëpunimi me përfaqësues të shumicës së Ambasadave në Kosovë, Zyrës së BE-së në Kosovë, Zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë, si dhe projekteve të shumta që mbështesin Akademinë e Drejtësisë në ofrimin e trajnimeve. Në këtë kuadër janë zhvilluar takimet e rregullta me zyrën e OPDAT pranë Ambasadës së SHBA-së në Kosovë, me projektet e USAID-it sikurse Projekti për Drejtësi Komerciale dhe Projekti për Drejtësinë në Kosovë, me Ambasadën Britanike, respektivisht me projektin “Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosove”, me përfaqësues të projektit të BE / EUKOJUST dhe me ”Projektin për Kodin Civil”, me projektet e KE “ JUFREX “ projektin “ Parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave” me projektin “Programi Evropian për Arsimimin e Profesionistëve Ligjor për të drejtat e Njeriut (HELP)” me projektin e “KOSEJ 2” si dhe projektet e tjera të mbështetura nga OSBE, UNDP, IFC, UNODC, GIZ, IRZ, Organizatën Joqeveritare INJECT Kosova, dhe me odat

e profesioneve të lira në Kosovë. Në këto takime janë diskutuar nevojat dhe sfidat e AD-së në përmbushjen e mandatit ligjor, mundësitë e mbështetjes së projekteve, aktivitetet e realizuara dhe aktivitetet në proces si dhe çështje tjera të përbashkëta.

3.3.2 Zyra e Programeve Trajnuese- Departamentet e AD-së

Akademia e Drejtësisë për të realizuar funksionet e saj sipas ligjit është organizuar në punën e Zyrës së Programeve trajnuese, në kuadër të së cilës funksionojnë Departamenti i PTV-së, Departamenti i PTF-së dhe Departamenti i PHP-së si dhe Departamenti për Administratë dhe Financa. Përgjegjësia e zyrës së programeve trajnuese janë:

- Hartimi, mbikëqyrja e zbatimit dhe vlerësimi i ndikimit të programeve trajnuese;
- Koordinimi i hartimit të politikave, strategjive, objektivave dhe planeve për trajnime;
- Koordinimi i punës së departamenteve në funksion të zbatimit të trajnimeve.

Secili departament i programit udhëhiqet nga një udhëheqës të cilët po ashtu bëjnë pjesë në kategorinë e nivelit drejtues. Në kuadër të secilit program ka edhe nënkategori tjera të aktiviteteve të cilat janë në përshtatshmëri me funksionet themelore të secilit nga këto programe.

Departamenti për Administratë dhe Financave udhëhiqet nga Drejtori për Administratë dhe Financa, i cili po ashtu është nivel drejtues dhe përfshinë sektorë të cilët janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të përgjithshme si: financiare, të prokurimit, teknologjisë informative, personelit dhe logjistikës, në funksion të realizimit të objektivave programore të Akademisë.

4. Të arriturat dhe sfidat në zbatimin e Planit të Punës dhe Programin Trajnues Kornizë 2021-2022

Plani i punës për vitin 2021 ka përfshirë aktivitetet në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial të cilat janë realizuar përmes programeve të ndryshme trajnuese. Komponentet kryesore të Planit të Punës ishin:

- Trajnimet e Vazhdueshme;
- Trajnimet Fillestare;
- Trajnimet për Avancim;
- Hulumtimet dhe Publikimet;
- Trajnimet për Trajnues;
- Trajnimet për Menaxhimin e Gjykatave dhe Prokurorive;
- Trajnimet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive si dhe profesionistë tjerë nga fusha e gjyqësisë;
- Mesimi në distancë nëpërmes platformës E-Learning.

Programi Trajnues Kornizë 2021-2022, përkatësisht programi trajnues për vitin 2021 ka ofruar trajnimet nga fushat kryesore t duke përfshirë aspektin material dhe procedural të punës së

gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Pra, Programi trajnues ka ofruar këtë përmbajtje:

- Drejtësinë penale;
- Programet e specializuara;
- Drejtësinë civile;
- Drejtësia për fëmijë, aspekti civil dhe penal;
- Drejtësinë ekonomike;
- Drejtësinë administrative;
- Fusha e kundërvajtjeve;
- E drejta kushtetuese;
- Trajnimet për DHPGJS;
- Trajnimet për KEDNJ dhe të Drejtën e BE-së;
- Kompetenca interdisciplinare;
- Trajnimet kundërdiskriminimit;
- Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar;
- Programi për Hulumtime dhe Publikime;
- Trajnimi i stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive;
- Trajnimet për zyrtarët e Agjencisë për ndihmë juridike Falas;
- Trajnimin për përmbaruesit privat;
- Trajnimet e Trajnuesve;
- Trajnimet nga distanca;
- Trajnimet me donatorë.

4.1 Sfidat në zbatimin e programeve trajnuese gjatë vitit 2021

Ndër sfidat më të mëdha me të cilat është përballur Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2021 ishin:

- Cilësia jo e mjaftueshme e trajnimeve të realizuara përmes platformës ZOOM;
- Mungesa e paisjeve të mjaftueshme për të identifikuar vërtetësinë e përfituesve në trajnimet përmes platformës ZOOM;
- Zbatimi i metodologjisë trajnuese në trajnimet përmes platformës ZOOM
- Pjesmarrja në takime dhe konferenca regjionale virtuale dhe mungesa e përkthimit adekuat.
- Lëvizja dhe largimi i stafit të lartë profesional (brenda 9 viteve janë larguar 11 zyrtarë të lartë profesional dhe drejtues), e cila vë në rrezik përmbushjen e objektivave;
- Mos kompletimi i legjislacionit primar dhe sekondar nderlidhur me mandatin, funksionin dhe kompetencën sipas nevojave reale të AD-së.
- Procesi i racionalizimit dhe rishikimi funksional
- Zhvillimet në gjyqësor dhe ndryshimet legjislative kanë ndikim drejtpërdrejt në punën e Akademisë, dhe paraqesin sfida të vazhdueshme në realizimin me sukses të objektivave;
- Mungesa dhe koordinimi jo i mjaftueshëm ndër-institucional me institucionet përgjegjëse të sistemit të drejtësisë në vendin tonë;
- Ndërtimi i sistemit të monitorimit të trajnimeve dhe efektit të tyre në punë;

- Mungesa e literaturës dhe burimeve tjera për trajnime në gjuhën shqipe;
- Zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të trajnimit veçanërisht të metodologjisë së trajnimit të bazuar në raste praktike, respektivisht në lidhje me praktiken e GJEDNj.
- Mungesa e stafit profesional të nevojshëm dhe të domsdoshëm.
- Mungesa e hapësirave adekuate për trajnime.

Pavarësisht sfidave të lartpërmendura, Akademia e Drejtësisë është angazhuar për ti adresuar dhe tejkaluar ato duke përbushur me sukses aktivitetet e përcaktuara me planin e punës dhe jo vetëm por edhe aktivitete tjera të cilat kanë hyrë në program si rezultat i kërkesave nga partnerët ndërkombëtarë. Për vitin 2022, aktivitetet e Akademisë që do të realizohen janë të përcaktuara në Programin Trajnues 2022 si dhe në Planin e Punës dhe të performancës për vitin 2022. Këto aktivitete synojnë trajtimin e praktikës gjyqësore në të gjitha lëmitë me fokus në çështjet më sfiduese në procesin e bërjes së drejtësisë të cilat kanë qëllim tejkalimin e tyre dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare të përfituesve të saj siq janë të përcaktuar me ligj.

Përkundër iniciativës së ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë dhe Akademisë së Drejtësisë në zhvillimin e koncept dokumentit për fuqizimin e AD nëpërmes grupit punës, Qeveria me propozim të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka vazhduar me zbatimin e procesit të racionalizimit të Agjencive të Pavarura në kuadër të cilit proces është përfshirë edhe Akademia e Drejtësisë. Këto zhvillime padyshim se ishin sfiduese për AD-në në përpjekjet për fuqizimin dhe ruajtjen e pavarësisë institucionale të AD-së. Janë zhvilluar debate brenda për brenda AD-së dhe në takimin e jashtëzakonshëm të Këshillit Drejtues janë shprehur qëndrimet se AD duhet të qëndrojë si institucion i pavarur dhe se amandamentet ligjore të përfshira në draft Ligjin për Racionalizimin e Agjencive të pavarura e që ndërlidhen me Akademinë e Drejtësisë të tërhiqen.

4.2 Të arriturat nga aktivitetet në mbështetje të mekanizmave integruar për BE

Akademia e Drejtësisë ka ofruar kontributin e saj në planifikimin e strategjive që i kontribuojnë sundimit të ligjit. Në këtë vështrim ka qenë pjesë e planifikimit strategjik për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave që do të mbuloj vitin 2022-2026. Gjithashtu ka zbatuar aktivitetet që dalin nga kërkesat e dokumenteve tjera strategjike në nivel nacional si dhe të MSA-së dhe raportit të BE-së për Kosovë duke raportuar në baza të rregullta në institucionet dhe mekanizmat përkatës për aktivitetet në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, shëlarjes së parave duke përbushur masat e planifikuara gjatë vitit. Bazuar në Raportin përfundimtar të zbatimit të PKZMSA-së për vitin 2021, Akademia e Drejtësisë 100% ka zbatuar masat e planifikuara.

Përveç mekanizmave euro integruar, Akademia e Drejtësisë në vazhdimësi ka bashkëpunuar me KGJK dhe KPK dhe njësitë për shqyrtimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve që veprojnë në kuadër të dy këshillave duke i ofruar të dhëna mbi vijueshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnime. Gjithashtu për nevoja të raportimit ose edhe të prezantimit institucional në konferenca, takime dhe forma tjera janë nxjerrë të dhëna statistikore për aktivitetet trajnuese dhe detajet tjera që tregojnë angazhimin e Akademisë në ngritje të kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë sipas ligjit.

4.3 Të arriturat në zbatimin e programit trajnues 2021

Në Programin kornizë 2021-2022, përkatësisht aneksi për vitin 2021 janë parapare 95 trajnime të cilat i janë dedikuar gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve tjerë ligjor të cilat janë realizuar në tërësi. Poashtu në bashkëpunim me projektet ndërkombetare janë realizuar edhe 33 trajnime tjera apo 34.73% më shumë se që kanë qenë të planifikuara. Pra, mund të nxjerrim përfundimin se jo vetëm që trajnimet e planifikuara janë realizuar 100%, por janë shtuar dhe realizuar edhe 34.73 % më shumë.

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë ka trajnuar në total 351 gjyqtarë dhe 129 prokurorë. Pra, nga totali prej 391 gjyqtarë sa janë në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës janë trajnuar 351 gjyqtarë, apo 88.49 % e të gjithë gjyqtarëve. Ndërsa, nga totali prej 182 prokurorë sa janë në sistemin prokurorial, 129 janë trajnuar në programet trajnuese të AD- së, apo 70.87 % e të gjithë prokurorëve.

Për më shumë në total janë realizuar 128 trajnime me gjithsej 173 ditë, ndërsa në kuadër të trajnimeve fillestare janë realizuar 197 ditë trajnimi për 24 gjyqtarët e sapo emëruar, prej tyre 113 ditë të trajnimit teorik dhe 84 ditë të trajnimit praktik.

Programi për Trajnim të Vazhdueshëm 2021					
Përfituesit	Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve/prokurorëve	Numri i të trajnuarve nga numri i përgjithshëm	Pjesmarrja në trajnime sipas përqindjes	Numri i trajnimeve	Numri i trajnimeve në ditë
Gjyqtar	391	351	88.49%	128	173
Prokuror	182	129	70.87%		
Programi për Trajnim Fillestar 2020 -2021					
Gjyqtar të sapo emëruar	24	24		226 sesione	197

Tabela Nr.1 Aktivitetet e realizuara në trajnimin e vazhdueshëm dhe fillestar

4.4 Krahasimi i punës së Akademisë në tri vitet e fundit

Për vite me radhë gjyqësori ka pasur zhvillime të reja qoftë në lëvizjen e gjyqtarëve nga një nivel në nivelin tjetër, rekrutime të gjyqtarëve të rinj, ndryshime legislative etj. Të gjitha këto edhe kërkesat e dokumenteve strategjike të vendit duke përfshirë edhe gjetjet e raportit të BE-së për Kosovën të cilat kërkojnë përmirësimin e cilësisë së punës në Gjykata dhe Prokurori kanë pasur impakt edhe në planet dhe programet e trajnimit të Akademisë.

Zhvillimet e Akademisë në raport me vitet paraprake janë të prezantuara më poshtë në formë tabelare.

Përshkrimi i aktivitetit	2019	2020	2021
Tranime të vazhdueshme	146	109	128
Trajnime fillestare	Prokurorët e sapo emëruar, gjen. VII (65 ditë trajnimi) Gjyqtarët e sapo emëruar, gjen. VI (5 gjyqtarët nga minoriteti serb) 84 ditë të trajnimit	Prokurorët e sapo emëruar gjen. VIII 125 trajnimi Gjyqtarët e sapo emëruar, gjen. VII	Për 24 gjyqtarët e sapo emëruar, gjen. VIII janë realizuar 197 aktivitete trajnuese

	Prokurorët e sapo emëruar, gjen. VIII - 127 ditë trajnimi	janë realizuar 73 dite trajnimi,	
	Gjyqtarët e sapo emëruar, gjen. VII (185 ditë trajnimi)		
Trajnime për stafin adm. të gjykatave/ prokurorive	12 sesione (22 ditë trajnimi)	10 sesione me 11 ditë trajnimi	9 sesione trajnuese me 10 ditë trajnimi
Trajnime për profesionet e lira	12 sesione trajnuese për zyrtarët e ndihmës juridike falas	1 sesion trajnuese per permbaruesit privat, 4 për zyrtarët e ndihmës juridike falas 9 sesione të përbashkëta (Avokatë shtetëror me gjyqtarë dhe prokurorë)	2 sesione per permbaruesit privat dhe 1 sesion trajnues për zyrtarët e ndihmës juridike falas
Aktivitete tjera ²	31	179	122
Numri i pjesëm.gjyqtarë/prokurorë në trajnime	1992 ³	2558	2992 ⁴ gjyqtarë, 723 ⁵ prokuror,
Numri i gjyqtarë dhe prokurorë të sapo emëruar	5 gjyqtarë, gjen. VI 21 prokuror, gjen VII 39 gjyqtarë, gjen. VII 12 prokurorë, gjen. VIII	37 gjyqtarë të sapo emëruar 12 prokurorë të sapo emëruar	24 gjyqtarë
Numri i pjesëmarrësve nga stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial	235 vetëm nga programi për stafin administrative ndërkaq në trajnimet së bashku me gjyqtarë dhe prokurorë edhe 770	105 bashkëpunëtorë professional dhe zyrtarë ligjor si dhe 132 kategori tjera të stafit administrativ	49 bashkëp.prof dhe zyrtarë ligjor, 3 referentë dhe 1 mbrojtës i vktimave në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë, në trajnime veçanërisht per stafin administrativ 185 gjithësejt
Numri i personelit	29	27	26

Tabela nr.2. krahasimi i punës së Akademisë në tri vitet e fundit;

² Aktivitetet tjera nënkuptojnë, tryeza pune, konferenca, takime pune me trajnues dhe Kryetarë të Gjykatave e Kryeprokurorë të Prokurorive, Trajnime për Trajnues., vizita të ndërsjella në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtarë, punëtori të ndryshme, takime koordinuese etj.

³ Numri 1992 ka rezultuar meqë disa nga gjyqtarët dhe prokurorët kanë marrë pjesë më shumë se një herë.

⁴ Gjyqtarë që kanë marrë pjesë në më shumë trajnime se njëherë.

⁵ Prokurorë që kanë marrë pjesë në më shumë se njëherë në trajnime.

Buxheti përfundimtar për vitet 2019 – 2021			
Përshkrimi	2019	2020	2021
Pagat dhe Meditjet	195,716.34	219,038.08	212,350.58
Mallrat dhe Shërbimet	370,400.00	292,795.84	312,017.69
Shpenzimet Komunale	10,500.00	8,069.34	7,180.89
Shpenzime Kpaitale	563,000.00	-	-
Totali	1,139,616.34	519,903.26	531,549.16

Tabela nr. 3 Krahasimi i buxhetit për tri vite

4.5 Arritja e objektivave në kuadër të Programeve të Akademisë së Drejtësisë

Programi trajnues për vitin 2021 në përgjithësi është realizuar me sukses konform objektivave të përcaktuara në këtë program. Trajnimet në masë të konsiderueshme janë realizuar online për gjyqtarë dhe prokurorë, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial ndërkaq disa prej tyre edhe në formë të kombinuar ose edhe me pjesëmarrje fizike duke respektuar masat për parandalim të përhapjes së COVID 19. Përvetësimi i shkathtësive të zyrtarëve përgjegjës në aplikimin e platformës ZOOM ka qenë përparësi duke arritë zbatimin e plotë të aktiviteteve të parapara në këtë plan.

Trajnimet e vazhdueshme janë realizuar sipas kalendarit trajnues në formën online dhe në mënyrë të kombinuar ndërkaq trajnimet fillestare me praninë fizike meqë numri i pjesëmarrësve ishte i mjaftueshëm për të siguruar distancën për mbrojtje nga COVID 19.

Procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë është realizuar me sukses sepse janë përfshirë gjithë akterët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial duke konsumuar gjitha burimet e informacionit përfshirë edhe rekomandimet që dalin nga dokumentet strategjike të vendit. Në përfundim të këtij procesi është hartuar raporti i cili është analizë e vlerësimit të nevojave trajnuese për vitin 2022 që njëkohësisht prezanton ecurinë e procesit, metodologjinë si dhe rezultatet dhe të gjeturat nga ky proces.

Në fushën e publikimeve janë zhvilluar doracakë të ndryshëm që lehtësojnë punën praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe janë zhvilluar module trajnuese që do të shërbejnë për zbatimin e programeve trajnuese.

Në sektorin e financave janë realizuar të gjitha pagesat me kohë për obligimet që kanë rrjedh gjatë këtij viti, edhe pse ka pasur vështirësi dhe vonesa, plani i prokurimit është realizuar në përgjithësi.

4.6 Ngritja e cilësisë së trajnimeve dhe avancimi i metodologjisë trajnuese në programet e Akademisë së Drejtësisë

Ngritja e cilësisë së trajnimeve dhe avancimi i metodologjisë trajnuese ka vazhduar të jetë prioritet për AD-në edhe gjatë kësaj periudhe raportuese. Në këtë drejtim rëndësi e veçantë i është kushtuar hartimit të rekomandimeve nga trajnuesit duke përfshirë edhe konkludimet përfundimtare qoftë nga trajnimet ashtu edhe nga tryezat të cilat në vijim kanë shërbyer në hartimin e programit trajnues të radhës. Në vijim përmbajtja e trajnimeve është kujdesur të orientohet në praktikën gjyqësore dhe

të realizohet përmes rasteve studimore duke përfshirë edhe punën në grupe si forma më adekuate për trajtimin e çështjeve të ndryshme ligjore. Për avancimin e mëtejshëm të metodologjisë trajnuese nga projektet me donatorë janë përfituar 5 paisje të teknologjisë si SMART BOARD të cilat mbulojnë kapacitetet e sallave të trajnimeve në dispozicion si dhe do të ndihmojnë matjen e efektit të trajnimeve. Për cilësi në trajnimegjithashtu AD në mbështetje të Projektit I PROCEEDS ka angazhuar ekspertizë ndërkombëtare veçanërisht për luftimin e krimit kibernetik për të cilat sistemi ynë gjyqësor dhe prokurorial nuk e ka përvojën e duhur. Me rastin e hartimit dhe zbatimit të trajnimeve ka bashkëpunuar ngushtë me KGJK dhe KPK duke përfshirë edhe gjyqtarë, prokurorë si dhe trajnues me përvojë me qëllim të zbatimit të praktikave më të mira të trajnimit gjyqësor.

Tranimet edhe gjatë kësaj periudhe kanë vazhduar të mbahen në formë virtuale për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia COVID, ndërkaq në ato trajnime ku përfituesit ishin më të paktë në numër edhe me pjesëmarrje fizike. Zbatimi i trajnimeve përmes Platformës ZOOM deri dikund ka përmbushë pritjet e përfituesve meqenëse e ka përkrahë metodologjinë trajnuese të bazuar në raste studimore duke përfshirë edhe përkthimin. Stafi i Akademisë ka qenë i përkushtuar në ofrimin e udhëzimeve për përdorim nga ana e përfituesve të trajnimeve dhe në vazhdimësi ka siguruar asistencë për vijimin e trajnimeve për të gjithë të interesuarit.

4.7 Procesi i vlerësimit të nevojave për trajnime dhe përditësimi i programeve trajnuese

Vlerësimi i nevojave trajnuese është obligim ligjor i Akademisë së Drejtësisë i cili bëhet përmes mekanizmave të përcaktuar nga Akademia dhe në bazë të kërkesave të KGJK-së dhe KPK-së. Në periudhën raportuese procesi për vlerësimin e nevojave trajnuese për vitin 2022 ka filluar që nga zbatimi i Programit të Trajnimeve për vitin 2021, fillimisht me analizën dhe nxjerrjen e propozimeve nga formularët e vlerësimit pas secilit sesion trajnues. Në gjysmëvjetorin e dytë të këtij viti janë dërguar pyetësorët në gjykata dhe prokurori rezultatet e të cilave janë pranuar dhe janë marrë për bazë gjithashtu.

Në kuadër të këtij procesi janë përfshirë edhe takimet me kryetar të gjykatave, gjyqtarë dhe udhëheqës të departamenteve si dhe kryeprokuror të prokurorive të cilat janë realizuar kryesisht në muajin korrik, gusht dhe shtator të vitit 2021. Në vazhdim gjatë këtij viti janë përcjellë raportimet nga mediat për gjyqësorin, janë analizuar raportet dhe rekomandimet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, strategjitë dhe dokumentet e miratuara nga institucionet të cilat përmbajnë rekomandime për gjyqësorin dhe sundimin e ligjit⁶, raportet e punës të gjykatave dhe prokurorive si dhe agjenda legjislative në Kuvendin e Kosovës. Vëmendje të veçantë kanë pasur edhe rekomandimet nga, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit. Përveç mekanizmave të lartpërmendur për çështje krahasimore në këtë proces janë përfshirë edhe analiza dhe hulumtimi i programeve të institucioneve trajnuese regjionale dhe ndërkombëtare. Rezultatet dhe të gjeturat nga mekanizmat përkatës kanë qenë burime referuese dhe përcaktuese për programin trajnues për vitin 2022 nga krerët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe nga Këshilli Programor dhe Këshilli Drejtues i AD-së. Në vijim gjenden mekanizmat për vlerësim (burimet e informacionit) të cilat janë shqyrtuar dhe konsultuar nga Akademia e Drejtësisë gjatë procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese:

⁶ Akademia e Drejtësisë ka qenë pjesë e grupit punues për hartimin e Strategjisë për mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Ka dhënë kontributin e saj edhe në dokumentet tjera strategjike duke planifikuar masa në përmbushje të kërkesave që dalin nga këto strategji në nivel nacional.

- Formularët për vlerësim pas sesioneve trajnuese 2021
- Pyetësi për vlerësimin e nevojave trajnuese
- Propozimet e trajnueseve të përhershëm të AD-së
- Takimet e kryetar të gjykatave, gjyqtarë udhëheqës të departamenteve
- Takimet me kryeprokuror dhe prokuror
- Raportet e punës së KGJK-së dhe KPK-së
- Raportet e punës së gjykatave dhe prokurorive
- Strategjitë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave
- Strategjia për sundimin e Ligjit 2021-2026
- Strategjia për mbrojtjen e të drejtave të njeriut 2021-2025
- Rishikimi funksional për sundimin e ligjit
- Strategjia shtetërore në luftën kundër korrupsionit 2019-2023
- Strategjia në luftën kundër krimit të organizuar 2018-2023
- Strategjia kombëtare e Rep. Së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e e konomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2019-2023
- Avokati i popullit
- Mediat e shkruara dhe elektronike
- Agjenda legislative e Kuvendit të Kosovës
- Programet e institucioneve të trajnimit gjyqësor në nivel regjional dhe ndërkombëtar
- Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja dhe përpunimi i të gjitha të dhënave nga mekanizmat e lartpërmendur ka kërkuar kohë dhe përkushtim. Sidoqoftë Programi trajnues për vitin 2022 i AD-së është hartuar duke pas në konsideratë këto burime.

4.8 Punëtorja për hartimin e Programit trajnues për vitin 2022

Në periudhën raportuese Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Këshillin e Evropës ka realizuar një Punëtori për Hartimin e Programit Trajnues për vitin 2022.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte përcaktimi i Kurikulës Trajnuese për vitin 2022, në pajtim me nevojat trajnuese të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor si dhe kërkesave dhe prioriteteve tjera të sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Në kuadër të kësaj punëtorie janë prezentuar të gjeturat nga zbatimi i mekanizmave për vlerësim të nevojave trajnuese si dhe aktivitetet trajnuese të planifikuara nga Programi Kornizë 2021-2022 të planifikuara për vitin 2022. Grupet punuese të ndara sipas fushave kanë punuar në zhvillimin e koncepteve të trajnimit sipas kurikulës trajnuese të përcaktuar për vitin 2022. Pjesëmarrës në këtë punëtori janë: Kryesuesi i Këshillit Drejtues të AD-së, Kryesuesi i KGJK-së, përfaqësues nga Këshilli i Evropës, gjyqtar dhe prokuror nga të gjitha nivelet si dhe stafi i Akademisë së Drejtësisë nga radhët e departamentit të programit.

5 Aktivitetet e realizuara sipas programeve të AD-së

Aktivitetet trajnuese në kuadër të programeve të cilat ofron AD kanë qenë të orientuara në praktikën gjyqësore të çështjeve ligjore duke përfshirë aspektin material dhe procedural. Duke qenë se edhe viti 2021 u përballë me rrethanat pandemike, trajnimet dhe aktivitetet tjera në pjesën dërmuese u realizuan online. Raporti në vijim përmban aktivitetet sipas programeve:

- Programi i Trajnimit Fillestar;
- Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm;
- Programi për Hulumtime dhe Publikime;
- Mësimi në distancë;
- Trajnimet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive;
- Trajnimet për profesionet e lira
- Trajtime për Trajnues;
- Punëtori, tryeza pune, konferenca dhe aktivitete tjera;
- Bashkëpunimi me donatorë;
- Bashkëpunimi ndërkombëtarë;
- Programi për praktikant-student;
- Administrata dhe Financa.

Në tabelen nr. 2 paraqiten trajnimet dhe aktivitetet tjera të realizuara nga Akademia gjatë vitit 2021

Numri i përgjithshëm i aktiviteteve të AD-së 2021	Nr.
Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm	128
Programi i Trajnimit Fillestar	197
Staf Administrativ i Gjykatave dhe Prokurorive	12
Profesione të lira	15
Trajnime të Trajnuesve	10
Mësimi në distancë	5
Takime	26
Punëtori	8
Tryeza	5
Ceremoni	4
Vizita studimore	1
Forume ligjore	1
Marrëveshje bashkëpunimi me GIZ	1
Mirënjohje nga Universiteti i Mitrovicës " Isa Boletini"	1

Tabela nr.4: Aktivitetet e realizuara në të gjitha programet e AD-së

5.1 PROGRAMI I TRAJNIMIT FILLESTAR

Akademia e Drejtësisë në kuadër të mandatit të saj organizon trajnimin fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar. Qëllimi i këtij programi qëndron në zhvillimin e kompetencave profesionale, vlerave etike dhe ndër personale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar.

Programi i trajnimit fillestar (më tutje PTF) zgjatë 12 muaj dhe realizohet fillimisht përmes trajnimit teorik ku përfshihen të gjitha degët e së drejtës dhe ligjeve vendore, Acquis Communautaire, Konventa Evropiane për të Drejta e Njeriut dhe akte të tjera ndërkombëtare po ashtu përfshinë edhe trajnime me karakter interdisiplinarë.

Trajnimi praktikë zhvillohet në gjykata/prokurori ku ata janë emëruar dhe fokusohet në zhvillimin e shkathtësive praktike të punës së gjyqtarit/prokurorit. Gjithashtu, në kuadër të trajnimit praktik përfshihen edhe vizitat në institucionet jo gjyqësore që janë rëndësishme dhe që lidhën me punën e gjyqtarit dhe prokurorit.

5.1.1 Të arriturat dhe sfidat sipas objektivave të parapara në Programin e Trajnimit Fillestar dhe Planin e Punës për vitin 2021

Në periudhën raportuese, Programi Fillestar me sukses ka përbushur trajnimin teorik dhe praktik për 24 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së VIII. Objektivat e këtij programi ishin të orientuara në ngritjen e kapaciteteve profesionale për legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar, hartimin e drejtë të vendimeve gjyqësore, zhvillimin e shkathtësive gjyqësore dhe sociale, analizën e fakteve, aplikimin e rregullave etike, zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese dhe menaxhuese duke përbushur kështu edhe kompetencën profesionale dhe interdisiplinare të tyre.

Edhe gjatë vitit 2021 gjendja pandemike, ka qenë sfidë në zbatimin e metodologjisë trajnuese për disa aktivitetet konkrete. Në këtë drejtim, Akademia e Drejtësisë ka ndërmarrë veprime në bazë të vendimeve dhe udhëzimeve të organeve kompetente duke hartuar planin për menaxhimin e situatës dhe masave preventive ndaj virusit COVID-19, i cili ka mundësuar realizimin e trajnimeve në të njëjtën kohë sipas kalendarit trajnues përmes metodologjisë së kombinuar fizike dhe atë virtuale.

Programi për Trajnimin Fillestar 2021												
Gjyqtarë të sapoemëruar	Gjinia		Përkatësia Etnike			Totali i ditëve të trajnimit	Ditë trajnimi teorik	Ditë trajnimi praktik	Sesionet Trajnuese	Orë Trajnimi	Trajner të angazhuar	Mentor të angazhuar
	M	F	SH	SR	TJ							
24 Gjyqtarë	16	8	22	2	0	197	113	84	226	678	38	44

Tabellanr. 5 sesionet trajnuese për 24 gjyqtarët e sapo emëruar, gjeneratën e VIII në PTF

5.1.2 Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar, gjenerata e VIII (2021-2022)

Gjenerata e VIII e gjyqtarëve të sapo emëruar e përbërë prej 24 gjyqtarëve, ka filluar trajnimin fillestar me 18 shkurt 2021. Me rastin e fillimit të këtij trajnimi është realizuar paraprakisht një

ceremoni e fillimit të trajnimit fillestar që përmes komunikatës për shtyp të publikuar në portalin e AD-së janë ftuar dhe kanë marrë pjesë krerët kryesor të sistemit gjyqësor duke përfshirë edhe përfaqësues nga Ambasada e SHBA-së dhe Zyra e BE në Kosovë/Përfaqësuesi Special i BE-së.

Programi trajnues ka qenë i dizajnuar dhe përshtatur ndaj masave për parandalimin e COVID -19. Gjatë vitit 2021 në total janë realizuara 197 aktivitete trajnuese, prej tyre 113 ditë trajnimi teorik dhe 84 ditë trajnimi praktik.

Trajnimi teorik është zhvilluar në mënyrë të kombinuar me raste nga praktika gjyqësore, bazuar në module trajnuese ku përfshihen trajnime nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive, përfshirë këtu edhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe aktet tjera ndërkombëtare. Sipas këtij programit janë realizuar shtatë (7) module trajnuese, në kuadër të cilave përfshihen 49 nën module). Në trajnimin teorik për gjyqtarët në total janë realizuar 113 ditë trajnimi, 226 sesione trajnuese apo 678 orë trajnimi.

Modulet trajnuese të cilat kanë ndjekur gjyqtarët e sapo emëruar gjatë vitit 2021 janë:

- ◆ **Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale** - Në kuadër të këtij moduli janë realizuar 20 sesione apo 60 orë dhe janë trajtuar: Etika profesionale, ngritja e shkathtësive gjyqësore, menaxhimi i rasteve, rregullat e komunikimit dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore.
- ◆ **Rendi juridike kombëtar dhe ndërkombëtar** – Nga ky modul janë realizuar 17 sesione apo 51 orë dhe janë trajtuar: E drejta kushtetuese, organizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial, e drejta e BE-së, bashkëpunimi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut.
- ◆ **E drejta civile, administrative dhe ekonomike** - Në kuadër të këtij moduli janë realizuar 87 sesione 261 orë dhe janë trajtuar: E drejta civile, procedura kontestimore-pjesa e parë, procedura kontestimore-pjesa e dytë, e drejta detyrimeve, e drejta familjare, e drejta pune, procedura jokontestimore, procedura përmbartimore, e drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera të përfaqësuara, e drejta administrative, e drejta ekonomike tregtare, dhe e drejta trashëgimore.
- ◆ **Kodi Penal i Republikës së Kosovës** – Nga ky modul janë realizuar 37 sesionet trajnuese apo 111 orë dhe janë trajtuar: Kodi Penal-pjesa e përgjithshme, Kodi Penal-pjesa e veçantë, përgjegjësia e personave juridik, krimi kibernetik, si dhe udhëzuesi për politikën ndëshkimore.
- ◆ **Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës** – Nga ky modul janë realizuar 51 sesione trajnuese apo 153 orë në të cilat janë trajtuar: Masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit, kontrolli dhe konfiskimi, procedurat e veçanta sipas KPPK, shpenzimet e procedurës, mjetet juridike, shqyrtimi fillestar i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor, provat në procedurën penale, dëshmitarët dhe të dëmtuarit, si dhe të pandehurit në procedurën penale.
- ◆ **Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese**, - Në kuadër të këtij moduli janë realizuar 14 sesione apo 42 orë në të cilat janë trajtuar: Ndërmjetësimi, Ligji për kundërvajtje, Kodi i drejtësisë për të mitur, dhe zhvillimi i shkathtësive gjyqësore (simulim gjykimesh).

◆ **Mësimi nga distanca** janë realizuar dy nën module: **Anglishtja ligjore dhe Teknologjia Informativ**

Në grupin prej 24 gjyqtarëve, një prej tyre i është bashkangjitur trajnimit fillestar me një (1) muaj vonesë, për shkak se edhe dekretimi i tij është bërë më vonë nga Presidenca. Për këtë gjyqtarë veçanërisht janë ofruar tri module, përkatësisht 12 sesione trajnuese për të vazhduar më tutje bashkarisht me modulet e radhës me gjyqtarët tjerë të kësaj gjenerate.

Në realizimin e trajnimit teorik kanë qenë të angazhuar 38 trajnues. Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe metodologjisë trajnuese. Në programin e trajnimit fillestar janë përdorur këto metoda trajnuese:

- Metodologjia e bazuar në raste - që nënkupton se gjithçka është strukturuar rreth rasteve praktike;
- Simulim i gjykimeve dhe
- Teknikat e zhvillimit të përfaqësimit në gjykim

Në kuadër të trajnimit praktik, janë realizuar 84 ditë trajnimi praktik në gjykatat përkatëse ku ata janë të emëruar. Në realizimin e kësaj pjese të programit kanë qenë të angazhuar në total 44 mentorë prej tyre 20 në lëmin civile dhe 24 në lëmin penale të cilët kanë mbikëqyrë trajnimin praktik të gjyqtarëve të sapo emëruar të kësaj gjenerate.

Trajnimi praktik vazhdon edhe më tej deri në muajin mars 2022 në gjykatat përkatëse për modulën penal e gjithashtu sipas programit edhe në institucionet tjera jashtë gjyqësore.

Përveq trajnimeve praktike në gjykatat përkatëse, bazuar në plan programin e trajnimit fillestar, 24 gjyqtarët e sapo emëruar kanë realizuar 4 vizita në institucionet si: Agjencia për Informim dhe Privatësi, Shërbimi Sprovues, Policia e Kosovës dhe Dogana e Kosovës. Ky program përfshinë edhe trajnime-vizita edhe në institucione tjera të cilat priten të realizohen deri në përfundim të këtij programi.

5.1.3 Realizimi i testit përfundimtar

Bazuar në Rregulloren e Trajnimit Fillestar, testi përfundimtar (vlerësimi i përmbushjes së trajnimit) realizohet në dy pjesë përkatësisht pas periudhës gjashtëmujore të parë dhe në fund të trajnimit të trajtimit teorik dhe praktik. Hartimi i testit përfundimtar bëhet nga grupi punues i cili përbëhet nga trajnues të Akademisë, të cilët kanë qenë të përfshirë në realizimin e moduleve trajnuese.

Në periudhën raportuese Akademia e Drejtësisë me dt. 14 dhe 15 shtator 2021 ka realizuar testin përfundimtar për gjashtëmujorin e parë për modulet si në vijim: E drejta civile, ekonomike dhe administrative, Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale ” dhe “Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar.

Testi përfundimtar për modulet e gjashtëmujorit të dytë, përkatësisht për modulet në fushën penale për gjyqtarët e sapo emëruar të kësaj gjenerate pritet të realizohet në vitin 2022 pas përfundimit të trajnimit praktikë në këtë fushë.

5.2 PROGRAMI PËR TRAJNIME TË VAZHDUESHME

Trajnimet e vazhdueshme sipas Ligjit për AD-në i dedikohen gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë duke përfshirë edhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial dhe profesionistët tjerë ligjor. Ky program trajnimi ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve etike, profesionale, dhe praktike për ushtrimin e funksioneve të gjyqësorit. Nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme Akademia e Drejtësisë synon gjithashtu në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

5.2.1 Objektivat e Programit për Trajnim të Vazhdueshëm për vitin 2021

Gjatë periudhës raportuese trajnimet e vazhdueshme ishin në fokusuar në:

- Zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe asaj ndër personale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në funksion të zbatimit të drejtë të legjislacionit në fuqi;
- Unifikimin e praktikës gjyqësore dhe praktikave të mira profesionale;
- Zhvillimin e shkathtësive për pozitat drejtuese, si dhe promovimi i menaxhimit të mirë të rasteve,
- Ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial dhe profesionistëve tjerë si dhe
- Avancimin e njohurive të përfituesve rreth të drejtës Evropiane, të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare.

5.2.2 Aktivitetet trajnuese të zhvilluara në PTV

Nga muaji Janar-Dhjetor 2021, në kuadër të PTV-së janë realizuar 128 aktivitete trajnuese. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në këto aktivitete trajnuese ishte 3987, prej tyre 2992 kanë qenë gjyqtarë, 723 prokurorë dhe 272 profesionist tjerë.

Për më në detaje shih tabelën si në vijim:

Programi për Trajnim të Vazhdueshme 2021					
Përfituesit	Aktivitetet trajnuese	Ditë trajnimi	Pjesëmarrës	Mesatarja e pjesëmarrjes	Të trajnuar
Gjyqtarë	128	173	2992 ⁷	88.49%	346
Prokurorë			723 ⁸	70.87%	129
Bashkëpunëtor profesional dhe Zyrtar Ligjor			152	/	97
Stafi Administrativ gjyqësor dhe	12	13	161	/	105


⁷ Pjesëmarrja e gjyqtarëve më shumë se një herë

⁸ Pjesëmarrja e prokurorëve më shumë se njëherë

prokurorial dhe profesionistë tjerë ligjor⁹					
Kategori tjera në trajnime të vazhdueshme¹⁰			73	/	75
Avokat Shtetëror dhe Profesionet e tjera të lira¹¹	4	4	94	/	74
Trajnimet për Trajnues	10	31	133	/	97
Totali	154	221	4328		923

Tabela nr. 6 pjesëmarrja dhe numri i të trajnuarve në PTV

Raporti në vijim përfshinë aktivitetet e realizuara sipas fushave, trajnimet e realizuara në baza mujore, numrit të pjesëmarrjes, kohëzgjatjes së trajnimeve dhe detaje të rëndësishme për aspektin e trajnimeve.



Grafikoni nr. 73: Numri i trajnimeve të realizuara në PTV sipas fushave në vitin 2021


⁹ Mbrojtës të viktimave, zyrtarë policor, zyrtarë për informim etj.

¹⁰ Zyrtar nga Policia e Kosovës, Zyrtar ligjor nga Banka dhe Kompani të Sigurimeve, ATK, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komisioni i Ndhmës Shtetërore, Njësia e Intelejencës Financiare, Qendra për Promovimin e Drejtave të Grave, Zyrtar ligjor nga Oda e Përmbauesve Privat, Profesor, Staf i AD-së.

¹¹ Avokatë Shtetëror 05, Përmbaues Privat 30, Avokat 14, Zyrtar nga ANJF 25).




Grafikoni nr. 4 -Numri i trajnimeve të realizuara në baza mujore



Grafikoni nr. 5 Trajnimet sipas kohëzgjatjes në PTV

5.2.3 Pjesëmarrja në Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm


Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në trajnime të vazhdueshme ishte 3987. Prej tyre 2992¹² gjyqtarë, 723¹³ prokuror, 272 të tjerë si: bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor, avokatë shtetëror, stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial, pjesëtarë nga profesionet e lira duke përfshirë edhe ngritjen e kapaciteteve të trajnuesve. Nga këta pjesëmarrës, 3497 ishin shqiptarë, 437 serb, 28 boshnjak, 25 pakica të tjera, ndërsa në baza gjinore, 2468 pjesëmarrës ishin meshkuj dhe 1519 femra.



Grafikoni nr. 6: Numri i pjesëmarrësve në trajnimet e realizuara në PTV


¹² Gjyqtarë që kanë marrë pjesë në më shumë trajnime se njëherë.

¹³ Prokurorë që kanë marrë pjesë në më shumë se njëherë në trajnime.



Grafikoni nr. 7. Gjyqtarët e trajnuar në PTV gjatë vitit 2021

Në grafikonin në vijim prokurorët e trajnuar sipas niveleve dhe prokurorive:



Grafikoni nr. 8 Prokurorët e trajnuar në PTV

5.2.4 Trajnimet e vazhdueshme sipas fushave

Në fushën penale janë adresuar çështje ligjore të cilat vazhdojnë të jenë problematike si krimi i organizuar dhe korrupsioni, dhuna në familje dhe ngacmimi seksual, infrastruktura ligjore

në sferën e ekzekutimit të sanksioneve penale, konfiskimi i pasurisë, krimi ekonomik, hetimi financiar dhe pastrimi i parave, prokurimi publik, krimet e luftës, financimi i terrorizmit, trafikimi me qenie njerëzore si dhe çështje tjera me rëndësi të kësaj fushe.

Në fushën civile janë trajtuar kryesisht problemet detyrimore si kompensimi i dëmit, kontratat sipas LMD-së, të drejtat trashëgimore, pronësore, familjare. Edhe gjatë këtij viti rëndësi të veçantë në këtë fushë i është kushtuar Draftit të Kodit Civil. Poashtu në kuadër të fushës civile edhe përmes tryezave janë adresuar sfidat në praktikën gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave nga procedura kontestimore.

Në raport janë të paraqitura edhe aktivitete që kanë trajtuar çështje nga fusha tjera të së drejtës si Drejtësia për fëmijë aspekti civil dhe penal, trajnime për DHPGJS, nga e drejta ekonomike, e drejta administrative, e drejta kushtetuese, e drejta ndërkombëtare dhe e BE, të drejtat e njeriut, barazia gjinore dhe për mos-diskriminimin, aspekte materiale dhe procedurale nga lëmia e kundërvajtjeve, si dhe tema të karakterit interdisiplinar.

5.2.5 Fusha penale (materiale dhe procedurale)

Janë realizuar 47 aktivitete trajnuese nga lëmia penale. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, janë trajtuar çështje nga e drejta penale materiale dhe procedurale.

Nga e drejta materiale penale janë realizuar trajnimet si: veprat penale kundër narkotikëve – më theks të veçantë kur kryhen në formë të organizuar, dhuna në familje, trafikimi i qenieve njerëzore, veprat penale kundër detyrës zyrtare, krimet e urrejtjes, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar, krimi i organizuar, veprat penale kundër martesës dhe familjes, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet e krimit kibernetik, uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave, krimet e luftës, dhuna ekonomike si dhe përgjegjësia penale e personave juridik.

Këto tema janë trajtuar me qëllim që të:

- Zbatohen në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të kapitullit të veprave penale të narkotikëve, dhunën në familje dhe trafikimin me njerëz;
- Avancohen njohuritë rreth bashkëpunimit juridik ndërkombëtar për çështjet penale;
- Avancohen njohuritë për tu marrë me rastet e krimeve të luftës;
- Zbatohen drejtë legjislacionin lidhur me Trafikimin përmes internetit/online;
- Zbatohen e drejtë të institutit të përgjegjësisë penale të personave juridik.

Nga e drejta procedurale penale janë realizuar trajnimet si: procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore dy trajnime, webinar regjional për gjyqtarët lidhur me provat elektronike, kompensimi i viktimave të krimit në kuadër të sistemit juridik të Republikës së Kosovës, masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, paraburgimi dhe masat tjera për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë, Webinar për Gjyqtarë mbi Kripto Valutën, Provat në procedurë penale dhe ligjshmëria e tyre, Kriptoalutat dhe Pastrimi i Parave, Shqyrtimi gjyqësor dhe gjykimi në mungesë, Mbrojtja e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve (viktimave), si dhe dëshmitarët bashkëpunues

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte ngritja e shkathtësive të përfituesve lidhur me:

- Tejkalimin e sfidave në procedurën penale kur përfshihen kryerësit me çrregullime mendore;
- Avancimin e njohurive në lidhje me kriptovalutën dhe pasuritë e tjera virtuale;
- Zgjerojnë njohuritë për vendosjen e rasteve duke pasur për bazë edhe kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në harmoni me legjislacionin përkatës në fuqi;
- Sigurojnë prova të mjaftueshme dhe të pranueshme nga zbatimi i masave të fshehta;
- Vlerësojnë drejtë elementet për përcaktimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedure;
- Zbatojnë drejt bazën ligjore për sigurimin, përdorimin dhe ligjshmërinë e provave;
- Zbatojnë drejt dispozitat ligjore që rregullojnë gjykimin në mungesë si dhe
- Zhvillojnë drejtë seancën për shpalljen e personit dëshmitar apo të dëmtuar të mbrojtur.

Programet e specializuara të trajnimit

Në kuadër të Programeve të Specializuar janë trajtuar temat si:

- Krimi i organizuar dhe korrupsioni;
- Shpëlarja e parave dhe hetimi financiar;
- Program i Specializuar “Mashtrimi dhe Korrupsioni në Prokurim Publik;
- Krimi Kibernetik;
- Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi.

Të gjitha temat janë trajtuar në 3 sesione trajnuese në kohëzgjatje prej 6 ditëve, me përjashtim të prokurimi publik përmbajtja e të cilit është trajtuar për 2 sesione me kohëzgjatje 4 ditore.

Program i specializuar trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit

Ky programi kishte për qëllim avancimin e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve që merren me luftimin e veprave të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në kuadër të sesionit të parë të këtij programi janë trajtuar sfidat rreth kornizës ligjore ndaj krimit të organizuar dhe tregjet e krimit të organizuar, shkaqet dhe faktorët lehtësues të krimit të organizuar, infiltrimi i krimit të organizuar në biznese dhe në institucione publike, ndërlikohja ndërmjet krimit të organizuar dhe korrupsionit, format e krimit të organizuar. Sesioni i dytë ka përfshirë trajtimin e teknikave të veçanta hetimore të krimit të organizuar, mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të drejtat e viktimave tek krimi i organizuar, strategjitë e Prokurorisë për hetimin e grupeve kriminale dhe strategjive institucionale në fushën e bashkëpunimit në çështjet penale si dhe sekuestrimi i corpora delictit tek krimi i organizuar. Ndërsa, në sesionin e tretë janë trajtuar sfidat nga konfiskimi i pasurisë së fituar me anë të veprës penale, sanksionet penale kundër kryerësve të veprave penale të krimit të organizuar, lidhjet ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Programi i specializuar është realizuar në tri (3) sesione trajnuese, me gjithsej gjashtë (6) ditë trajnimi.

Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave

Ky program ka synuar avancimin e njohurive profesionale të gjyqtareve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë në zbatimin drejtë të dispozitave ligjore lidhur me kualifikimin juridik të veprave të pastrimit të parave. Gjithashtu në hetime proaktive penale dhe financiare dhe sigurimin e provave të pranueshme që mbështesin aktakuzat e ngritura, në shqiptimin e sanksioneve adekuate penale ndaj kryerësve të këtyre veprave penale si dhe sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë të fituar me vepra penale të shpëlarjes së parasë.

Përmbajtja e këtij programi të specializuar ishte fokus në trajtimin e çështjeve si: baza ligjore, vendore dhe ndërkombëtare për luftimin e pastrimit të parave dhe hetimet financiare, identifikimi i elementeve të veprës penale pastrimi i parave, fazat e pastrimit të parave, kompetencat dhe bashkëpunimi më njësinë për inteligjencë financiare, subjektet raportuese sipas ligjit për parandalimin e pastrimit të parave, hetimi dhe sigurimi i provave në rastet e pastrimit të parave, teknikat e ekzaminimit të mashtrimeve tek pastrimi i parave, mbledhja e informatave, përgatitja e profilit personal, gjurmimi i fondeve nga ana e marrësit, gjurmimi i fondeve nga ana e paguesit; rikthimi i pasurive të fshehura, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar me veprën penale – pastrimi i parave, bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar për luftimin e pastrimit të parave si dhe zgjidhjet e mundshme alternative.

Programi i specializuar është realizuar në tri (3) sesione trajnuese, me gjithsej gjashtë (6) ditë trajnimi.

Program i specializuar trajnimi për prokurimin publik

Në periudhën raportuese është realizuar edhe trajnimi i specializuar me temë: “Mashtrimi dhe Korrupsioni në Prokurim Publik”. Qëllimi i trajnimeve ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për gjitha fazat dhe procedurat e prokurimit, dosjet e tenderit, për të identifikuar më lehtë indikatorët e korrupsionit që lidhen me prokurimin publik.

Në kuadër të këtij programi janë trajtuar korniza institucionale në fushën e prokurimit publik, korrupsioni dhe mashtrimi në procesin e prokurimit, identifikimi i konfliktit të interesave në prokurim publik, procesi i planifikimit dhe fillimit të procedurës, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, ankesat dhe menaxhimi i kontratës, specifikime të manipuluar/përshtatja enkas e ofertave, mashtrime me fatura

Programi i specializuar është realizuar në dy (2) sesione trajnuese, me gjithsej katër (4) ditë trajnimi.

Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik

Bazuar në faktin që teknologjia informative po evoluon dita ditës, praktika ka treguar se gjyqtarët dhe prokurorët hasin vështirësi në përballje me realitetin e ri të botës kibernetike. Pikërisht për këtë AD ka ofruar trajnime të specializuara në këtë fushë për të aftësuar gjyqtarët dhe prokurorët në gjykimin e rasteve të krimit kibernetik. Veçanërisht programi ka ofruar praktikat më të mira në

fushën e bashkëpunimit ndërkombëtarë dhe mundësitë e ndjekjes së suksesshme të krimit kibernetikë me fokus të veçantë për provat elektronike, rëndësinë dhe veçoritë e tyre, si dhe mundësinë që të identifikojnë dhe vlerësojnë provat elektronike në përcaktimin e veprës penale.

Në kuadër të këtyre trajnimeve u trajtuan krimi kibernetik – tendencat dhe instrumentet, teknologjia e përfshirë në krimin kibernetik, krimi kibernetik si vepër penale në legjisllacionin e brendshëm, legjisllacioni, procedura dhe praktika në lidhje me provat elektronike, ligji procedural/masat hetimore në legjisllacionin e brendshëm, legjisllacioni ndërkombëtar/konventa Budapestit si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.

Programi i specializuar trajnimi Krimi Kibernetik është realizuar në tri (3) sesione trajnuese, me gjithsej gjashtë (6) ditë trajnimi.

Program i specializuar trajnimi Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi


Nevoja për ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në këtë fushë është parë si shumë e domosdoshme, marrë parasysh faktin që terrorizmi po paraqet kërcënim për sigurinë si në nivel nacional ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Synim kryesor i këtyre trajnimeve të specializuara ishte avancimi i njohurive, shkathtësive dhe kompetencave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në funksion të hetimit dhe gjykimit efektiv, të pavarur dhe profesional.

Çështjet sfidues dhe problematike të trajtuara në kuadër të kësaj fushe janë fokusuar në kornizën ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, parandalimin e terrorizmit, përballja me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që favorizojnë terrorizmin, teknikat e hetimit dhe të provuarit e terrorizmit, korniza strategjike dhe institucionale në fushën e bashkëpunimit në çështjet penale kundër terrorizmit, viktimat e terrorizmit dhe qasja në drejtësi nga perspektiva e viktimave, sanksionet penale kundër kryerësve të veprave penale të terrorizmit, lidhjet ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Programi i specializuar është realizuar në tri (3) sesione trajnuese, me gjithsej gjashtë (6) ditë trajnimi.

Pjesëmarrja në trajnimet e specializuara


Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2021, janë realizuar 5 trajnime të specializuara, me 14 sesione trajnimi, dhe me 28 dite trajnimi. Numri i pjesëmarrësve në këto trajnime ishte 447. Prej tyre 320 gjyqtarë, 120 prokuror si dhe 7 profesionistë tjerë ligjor që vinin nga radhët avokatë shtetëror, bashkëpunëtorë profesional si dhe zyrtarë policor. Nga këta pjesëmarrës, 405 ishin shqiptarë, 40 serb, 02 nga pakica të tjera, ndërsa në baza gjinore, 296 pjesëmarrës ishin meshkuj dhe 151 femra.



Grafikoni nr.9 Numri i trajnimeve të specializuara të realizuara

Target i AD-së për trajnimet e specializuara ishin gjyqtarët dhe prokurorët nga departamenti special si dhe departamenti i krimeve të rënda. Bazuar në të dhënat e AD-së nga departamenti special janë trajnuar gjithësejt 16 gjyqtarë, prej tyre 4 nga Gjykata e Apelit dhe 12 nga Gjykata Themelore ndërkaq nga Prokurra Speciale gjithësejt 2 prokurorë.

Në grafikonin në vijim jepen të dhënat për numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe profesionistëve tjerë ligjor të trajnuar në trajnimet e specializuara.




Grafikoni nr.10 Numri i të trajnuarve në trajnimet e specializuara

Trajnimet për mbrojtjen nga dhuna në familje

Përderisa gjykatat kanë vazhduar të përballen me rastet e dhunës në familje, Akademia e Drejtësisë në periudhën raportuese ka pasur në prioritet trajnimet në këtë fushë duke fuqizuar fillimisht kapacitetet trajnuese e gjithashtu edhe të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe akterëve tjerë relevantë që merren me rastet e dhunës në familje. Këto trajnime kishin qëllim që brenda afateve të caktuara

ligjore të ndërmirren veprimet konkrete dhe t’iu përgjigjen nevojave të viktimave duke caktuar masat e duhura ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Konventën e Stambollit.

Pra, fuqizimit të kapaciteteve trajnuese dhe zhvillimit të manualeve-udhëzuesve në këtë fushë (detajet e të cilave janë në vijim të këtij raporti te Trajnimet e trajnuesve dhe Veprimtaria botuese), janë realizuar 4 sesione trajnuese duke trajtuar mbrojtjen nga dhuna në familje si në aspektin civil ashtu edhe në aspektin penal. Numri i të trajnuarve është 140, prej tyre 110 gjyqtarë, 22, prokurorë, 2 bashkëpunëtorë profesional, 1 avokat shtetëror, 4 zyrtarë policor si dhe 1 mbrojtës i viktimave.



Grafikoni nr.11 Numri i pjesëmarrësve në trajnimet për dhunë në familje

5.2.6 Trajnimet nga fusha Civile (materiale dhe procedurale)

Në periudhën raportuese janë trajtuar çështje të rëndësishme duke u nisur nga ato pronësore, familjare, marrëdhëniet pasurore të bashkëshorteve, nga e drejta trashëgimore, kontratat e reja sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, problematikat në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore si dhe në unifikimi i praktikës gjyqësore në çështjet e caktuara. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe reformës ligjore në fushën e të drejtës civile konkretisht draftit të Kodi Civil. Synim kryesor i çështjeve të trajtuara nga fusha civile ishte ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve me qëllim që të:

- përcaktojnë drejtë kriteret për shpërblimin e dëmit;
- zgjerojnë njohuritë mbi parashkrimin dhe përcaktojnë kohën e rrjedhjes së parashkrimit;
- njohin pjesë të domosdoshme të trashëgimisë dhe kur cenohet pjesa e domosdoshme e trashëgimisë;
- vlerësojnë drejtë kushtet ligjore të cilat duhet të plotësohen për shpronësim;
- dallojnë kushtet ligjore të cilat duhet plotësuar për t’u konsideruar një kontratë nule dhe e rrëzueshme;
- avancojnë njohuritë në lidhje me mjetet e sigurimit të ekzekutimit të kontratave, që u shërbejnë në punë më cilësore në kuptimin e vendosjes profesionale në çështjet që kanë të bëjnë kontestet e kësaj natyre;
- zbatojnë drejtë procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje;
- ngrisin njohuritë për trajtimin e rasteve me element ndërkombëtar;
- dallojnë kontestet për zgjidhjen, anulimin, apo vërtetimin e nulitetit të kontratës mbi mbajtjen e përrjetshme dhe kontratës për cedimin e pasurisë për së gjalli;

- analizojnë dhe zbërthejnë procedurën e filluar nga punëmarrësit në rastet e shkeljeve të detyrave të punës nga ana e punëdhënësve si dhe
- avancojnë njohuritë rreth harmonizimit të vendimeve të gjykatave në çështjet familjare.

5.2.7 Trajnimet nga Drejtësia për fëmijë – aspekti civil dhe penal

Në fushën e drejtësisë për fëmijë janë realizuar 8 trajnime, prej tyre gjashtë (6) nga aspekti penal dhe dy (2) nga aspekti civil.

Në aspektin civil janë trajtuar tema si: Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre dhe Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje.

Qëllim i këtyre trajnimeve ishte ngritja e aftësive dhe shkathtësive të gjyqtarëve lidhur me:

- vlerësimin e rasteve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror;
- zbatimin e mbrojtjes efikase të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit.

Në aspektin penal janë trajtuar tema si: procedura përgatitore te kryesit e mitur të veprave penale, të miturit si kryes të veprave penale dhe kategorizimi i tyre, veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve, shqyrtimi gjyqësor të kryesit e mitur të veprave penale, llojet e masave dhe dënimeve që shqiptohen ndaj të miturve dhe angazhimi i fëmijëve në forma të rënda të punës dhe punë të detyruara.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive dhe shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me:

- çështjet problematike në praktikë me rastin e zhvillimit të procedurës përgatitore;
- avancimin e njohurive kur kemi të bëjmë me të miturin e ri dhe të miturin e rritur;
- analizimin e drejtë të veprimeve procedurale të cilat ndërmerren kur kemi të bëjmë me viktimën fëmijë;
- evidentimin e dilemave të mundshme që janë paraqitur në praktikën gjyqësore si dhe
- njohjen e kushteve ligjore për shqiptimin e masave apo dënimeve që mund të shqiptohen ndaj të miturit.

5.2.8 Trajnimet nga fusha Ekonomike

Në periudhën raportuese ka qenë prioritet konsolidimi i kurrikulës për drejtësi komerciale, zgjerimi dhe ngritja e kapaciteteve të trajnuesve të AD-së në këtë fushë me qëllim të përmirësimit të kualitetit të sistemit të drejtësisë në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Përveq kësaj janë realizuar edhe katër (4) trajnime në të cilat janë trajtuar çështjet si praktika gjyqësore komparative në lëmin e falimentimit në vendet e bashkimit evropian, të drejtat e pronësisë intelektuale, markat tregtare, patentat, zbatimi në praktikë i ligjit për shoqëritë tregtare, e drejta kontraktuese dhe kontratat e ndërtimit.

Përmes këtyre trajnimeve është synuar ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve në:

- avancimin e njohurisë të procedurave të hapjes së rastit të falimentimit;
- kuptimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;
- identifikimin e Shoqërive tregtare, specifikat dhe karakteristikat tjera si dhe

- rritjen e ekspertizës profesionale të gjyqtarëve rreth kontratës së ndërtimit, specifikat e saj në sferën kontraktuale.

5.2.9 Trajnimet nga fusha Administrative

Trajnimet në fushën administrative kanë adresuar sfidat në interpretimin e drejtë dhe të saktë të legjislacionit, me theks në interpretim dhe zbatimin të konfliktit administrativ dhe ndërlidhja në mes procedurave të parapara në ligjet e veçanta me Ligjin për Procedurën Administrative dhe Ligjin mbi Konfliktin Administrativ.

Në periudhën raportuese janë realizuar shtatë (7) trajnime që kanë përfshirë çështjet nga Ligjin dhe politika e konkurrencës dhe rregullimi i ndihmës shtetërore në Kosovë, për procedurën administrative lidhur me kërkesat nga lëmia e marrëdhënieve të punës, veçmas masat disiplinore, zbatimi i Ligjit për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti, për procedurën administrative në Administratën Tatimore dhe në Doganën e Kosovë, shqyrtimi kryesor, procedura e provave dhe barra e të provuarit në konfliktin administrativ, procedura administrative që nga shpallja e tenderit deri të vendimmarrja e OSHP si dhe çështje nga zbatimi i Ligjit për Regjistrimin Civil.

Realizmi i këtyre trajnimeve kishte për qëllim avancimin e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve në interpretimin dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore për procedurën administrative dhe procedurën e konfliktit administrativ.

5.2.10 Trajnimet nga E Drejta Kushtetuese

Në periudhën raportuese janë realizuar dy (2) trajnime nga lëmia e së drejtës kushtetuese me temë: Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave ankesave në lëmin civile dhe Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe efektet juridike të tyre.

Këto trajnime janë realizuar me qëllim të ngritjes së aftësisë profesionale rreth njohjes së rolit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe efekteve juridike të cilat i prodhojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese si dhe të kuptojnë rolin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.

5.2.11 Trajnime për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme

Në Programin Trajnues të vitit 2021 nuk kanë munguar edhe trajnimet dedikuar ekskluzivisht Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Për këtë kategori përfituese janë realizuar katër (4) trajnime si: Përputhshmëria e procesit dhe rregullave të tenderit me ligjin e AKP-së dhe ligjeve tjera; Prosesi i likuidimit vullnetar të ndërmarrjeve shoqërore, shqyrtimi para autoritetit të likuidimit dhe trajtimi gjyqësor në dhomën e posaçme; Trajtimi i kërkesave pronësore dhe kreditore; Trajtimi i kërkesave të punëtorëve lidhur me të drejtën e tyre në realizimin e 20 % nga shitja ndërmarrjeve shoqërore

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte ngritja e kapaciteteve profesionale në:

- Zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore për rregullat e tenderit gjatë procesit të privatizimit;
- interpretimin e drejtë të ligjshmërisë së lidhjes së kontratave të shitblerjes, faljes dhe arondimit të lidhura ndërmjet viteve 1950/60 dhe

- përcaktimin e kriterëve që duhet plotësuar punëtorët për të marrë pjesë në shpërndarjen e 20% e të ardhurave nga shitja e n.sh-së;

5.2.12 Trajnimet nga fusha e kundërvajtjeve

Kurikula trajnuese në fushën e kundërvajtjes është fokusuar kryesisht në zbatimin e akteve normative të cilat rregullojnë vepra të ndryshme kundërvajtëse, duke veçuar Procedurën kundërvajtësve sipas kërkesës së inspektoreve si dhe Kompetencën Lëndore dhe territoriale sipas Ligjit për Kundërvajtje.

Përmes trajtimit të këtyre temave është synuar ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve që të:

- zbatojnë drejtë procedurën e kundërvajtjes, të nxjerrin aktgjykim ligjor duke i aplikuar drejtë dispozitat ligjore dhe të
- identifikojnë rastet në kompetencën gjyqësore dhe atë të organit kundërvajtës.

5.2.13 Trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe BE-së

Se sa e rëndësishme është Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe cilat janë efektet e saj në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, Akademia e Drejtësisë këto çështje i ka adresuar përmes tetë (8) trajnimeve të realizuara gjatë vitit 2021.

Në kuadër të këtyre trajnimeve janë trajtuar dhe diskutuar përmes rasteve praktike të GJEDNJ-së dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me: Ndalimin i torturës, E drejta në pronë, E drejta e mbrojtjes së pronës - Neni 1. i Protokollit nr.1. të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, E drejta për jetë private, jetë familjare, të vendbanimit dhe korrespondencës, për tu martuar dhe krijuar familje dhe për barazi të bashkëshortëve – Neni 8 Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, E drejta për një proces të rregullt, Zbatimi gjyqësor i KEDNJ dhe efektet e nenit 53 dhe 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në praktikën gjyqësore në Kosovë, E drejta në mjetin juridik efektiv - Neni 13 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Trajnim tematik për qasje në dokumente publike dhe të drejtën për të ditur si dhe Trajnim tematik për mbrojtjen e sinjalizuesve. Trajnimet kishin për qëllim:

- ngritjen e kapaciteteve profesionale lidhur me zbatimin e nenit 1, 6, 8, dhe 13 të Konventës dhe të përvojës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me këto nene;
- avancimin e njohurive lidhur për rastet e GJEDNJ si dhe raste nga legjislacioni vendor lidhur me sinjalizuesit;
- thellimin e njohurive mbi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) mbi të drejtën e mbrojtjes së pronës si dhe
- zbatimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ lidhur me nenin 6 të KEDNJ.

Në kurikulen trajnuese janë përfshirë edhe trajnimet për të drejtën e BE-së si: E Drejta e Bashkimit Evropian dhe E Drejta Ekologjike e BE-së - Konventa e Arhusit, Rregulloret, direktivat, dhe aktet tjera juridike të BE –së. Trajnimet kishin për qëllim avancimin e njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me:

- zbatimin e drejtë të legjislacionit të BE-së në nivel nacional dhe zberthimin e rasteve praktike të zbatimit të së drejtës së BE-së nga ana e gjykatave të një shteti anëtar të BE-së;
- vlerësimin e të drejtave për qasje në informacionet mjedisore dhe analizimin e përgjegjesisë penale për ndotjen e mjedisit.

5.2.14 Trajnimet për mosdiskriminimin

Marrë parasysh rendësinë e barazisë gjinore në një vend dhe shoqëri demokratike, kurrikula trajnuese ka ofruar edhe trajnime nga kjo fushë përmes së cilës është synuar të fuqizohet dhe më tutje mosdiskriminimi në aspektin gjinor, nacional etj.

Në kuadrin e këtyre trajnimeve është trajtuara aspekti material dhe procedural i Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi dhe sfidat në zbatimin e tij. Poashtu edhe KEDNJ në rastet e diskriminimit përfshirë edhe Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi i Republikës së Kosovës dhe raporti i tij me ligjet e tjera me theks në Ligjin e Punës dhe Ligjin e Procedurës Kontestimore. Fokusi kryesor i këtyre trajnimeve ishte ngritja e aftësive dhe identifikimi i elementeve thelbësore të secilës formë të diskriminimit si dhe interpretimi i drejtë i dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me diskriminimin.

5.2.15 Trajnimet nga fusha e ndërmjetësimit

Në mbështetje të Programi të USAID-it për Drejtësi Komerçiale në periudhën raportuese është realizuar një trajnim për ndërmjetësimin dhe procedurat gjyqësore. Trajnimi përveq aspektit material të Ligjit për ndërmjetësimin ka trajtuar edhe aspektin procedural duke ofruar edhe praktikat më të mira të SHBA-ve në ndërmjetësimin. Trajnimin e kanë vijuar 41 gjyqtarë dhe 6 prokurorë.

5.2.16 Trajnimet nga kompetenca ndërdisiplinare


Në kuadër të kompetencës ndërdisiplinare gjatë vitit 2021 janë trajtuar temat si: Etika Profesionale Menaxhimi i stresit, Menaxhimi i rasteve dhe Arsyetimi i vendimeve gjyqësore. Këto trajnime u realizuan me qëllim të ngritjes së kapaciteteve ndërdisiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me etiken dhe integritetin, avancimin e shkathtësive në shkrimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore, ngritjen e shkathtësive praktike të menaxhimit të rasteve, si dhe aplikimin e metodave dhe teknikave për tejkalimin e situatave stresuese që shfaqen gjatë punës së përditshme.

5.2.17 Trajnimet e obligueshme për Etiken profesionale

Në përmbushje të kërkesave që rrjedhin nga aktet nënligjore të KPK-së, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, gjatë vitit 2021 ka realizuar trajnimet e obligueshme për Etiken profesionale për prokurorë.

Qëllimi i realizimit të këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve për Kodin e Etikës në përgjithësi, parimet bazë të etikës, përgjegjësit që rrjedhin nga zbatimi i ligjit për përgjegjësinë, shkeljet dhe masat disiplinore, konkretisht njohjes së kufirit dhe dallimit në mes shkeljes disiplinore dhe shkeljes procedurale.

Numri i prokurorëve që e kanë përfunduar trajnimin për Etiken profesionale gjatë 2021 është 156.



Grafikoni nr.12: Numri i prokurorëve që kanë ndjek trajnimin për Etiken Profesionale

5.2.18 Bashkëpunimi dhe mbështetja e donatorëve në ofrimin e Trajnimeve të Vazhdueshme

Mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë nuk ka munguar edhe në periudhën raportuese. Veçanërisht ka qenë e theksuar në ofrimin e ekspertizës në trajtimin e çështjeve specifike dhe në ngritjen e kapaciteteve të trajnuesve duke mos lenë asesi anash zhvillimin e metodologjisë bashkëkohore trajnuese.

Në grafikonin në vijim pasqyrohet nr. i trajnimeve të realizuara si rezultat i bashkëpunimit të ngushte me partnerë dhe donatorë të ndryshëm të cilët e mbështesin sistemin e drejtësisë.


Nr. i trajnimeve të realizuara nga Akademia e Drejtësisë në Bashkëpunim me Donatorët 2021 PTV	Nr.i Trajnimeve
Akademia e Drejtësisë	72
Mbështetje te Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionit për Ndihmë Shtetërore	1
Ambasada Amerikane	3
Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC)	2
Banka Botërore	1
AXIOM International	2
EULEX	1
Mbështetja e Kodit Civil Faza 2	6
EIPA	2
CEL (Center for Equality and Liberty Kosova)	2
IPROCEEDS	1
GIZ	5
UNDP	3
ILO - Organizata Ndërkombëtare e Punës	1

OSBE	6
IRZ	2
UNHCR	1
Forcimi i institucioneve të Kosovës në luftën kundër torturës, keqtrajtimit dhe trajtimeve tjera degraduese	3
USAID / Drejtësia Komerçiale	11
JUFREX (Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe)	3
Gjithsej trajnime	128

Tabela nr. 7: Numri i trajnimeve në bazë të financuesit

5.3 Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial është kategori përfituese e trajnimeve dhe shërbimeve tjera që ofron AD për përfituesit e saj sipas ligjit. Në periudhën raportuese i është kushtuar vëmendje e veçantë bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive. Bazuar në vlerësimin e nevojave trajnuese janë hartuar modulet e trajnimit bazik në fushën penale dhe civile të cilat përfshijnë aspektin material dhe procedural si dhe i'u është dhënë mundësia atyre dhe profileve të caktuara që të marrin pjesë në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë.



Grafikoni nr.14 kategoritë specifike të stafit administrativ në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë


Përveq kategorive të lartë theksuara edhe pjesëtarët tjerë nga radhët e stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial janë përfshirë në trajnimet që ka ofruar AD veçanërisht për natyrën e punës dhe kompetencat specifike që ata kanë. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte ngritja e vazhdueshme profesionale dhe përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve në gjykata dhe prokurori.

Gjatë periudhës raportuese për këtë kategori përfituese janë organizuar trajnimet si në vijim:


- Risitë në kompetencat dhe strukturën organizative dhe menaxheriale në sistemin gjyqësor
- Risitë në kompetencat dhe strukturën organizative dhe menaxheriale në sistemin prokurorial,
- Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor
- Menaxhimi i punës në administratën e sistemit prokurorial,

- Shkrimi dhe arsyetimi ligjor,
- Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor
- Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin prokurorial,
- Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun,
- Integriteti dhe sjelljet etike,
- Menaxhimi i kohës dhe stresit,
- Trajnimi në përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL),
- Trajnimet për sistemet audio/ video dhe për sistemet e mbrojtjes së dëshmitarëve.

Përmes grafikoneve në vijim gjenden të dhënat për numrin e trajnimeve, pjesëmarrësve, të trajnuarve dhe detajet tjera:



Grafikoni nr.15 trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial



Grafikoni nr. 16: Stafi administrativ i trajnuar

5.4 Trajnimi për profesionet e lira

Akademia e Drejtësisë sipas mundësisë dhe me kërkesë të institucioneve dhe odave të profesioneve të lira mund të ofrojë trajnime për këto kategori. Gjatë periudhës raportuese në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, Avokatët Shtetëror kanë marrë pjesë në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë. Poashtu janë realizuar dy (2) trajnime veçanërisht për përmbaruesit privat me temë: “Zhvillimi i ankandëve në procedurën përmbarimore” dhe Përmbarimi në sendet e paluajtshme si dhe 2 sesione për zyrtarë të ndihmë juridike falas me temë: “Barazia gjinore në përgjithësi, dhe në çështjet pronësore në veqanti”.

Këto trajnime kishin qëllim që të përmirësohet cilësia e shërbimeve në fushën e mbrojtjes, përmbarimit të vendimeve dhe të ofrimit të ndihmës juridike falas.

Në tabelën në vijim pasqyrohen detaje sa i përket pjesëmarrjes në trajnime nga profesionet e lira:

	Totali si pjesëmarrës * (Një pjesëmarrës është i llogaritur më shumë se një herë)	Të trajnuar *(Një pjesëmarrës është i llogaritur një herë edhe nëse ka marr pjesë në trajnime më shumë se një herë)
Avokatë Shtetëror	9	5
Mashkuj	5	3
Femra	4	2
Shqiptarë	9	5
	Totali si pjesëmarrës * (Një pjesëmarrës është i llogaritur më shumë se një herë)	Të trajnuar *(Një pjesëmarrës është i llogaritur një herë edhe nëse ka marr pjesë në trajnime më shumë se një herë)
Përmbarues Privat	44	30
Mashkuj	36	26
Femra	8	4
Shqiptarë	44	30
	Trajnimi i parë	Trajnimi i dytë
Zyrtarët e ndihmës juridike falas	11	14
Femra	6	6
Mashkuj	5	8

Tabela nr. 8 Profesionet e lira në trajnimet e AD-së

5.5 Trajnimet për Trajnues

Akademia e Drejtësisë, përveç trajnimeve për Gjyqtarë, Prokurorë, staf administrativ të Gjykatave dhe Prokurorive, gjithmonë ka pasur për qëllim edhe ngritjen e shkathtësive dhe metodologjive trajnuese për trajnuesit e saj.

Kjo gjë është reflektuar edhe gjatë vitit 2021, ku si asnjëherë më parë ka pasur ngritje të numrit të Trajnimeve për Trajnues të cilat kryesisht ishin në fushën komerciale, dhunë në familje dhe aspekti i të drejtave të njeriut dhe mos diskriminimi si dhe për evidencat penale. Numri i TIT ishte **(10)** gjithsejt me 31 ditë trajnimi për të vetmin qëllim që trajnuesit e AD-së të aftësohen dhe të jenë në hap me përditësimet e fundit në metodologjitë trajnuese dhe ndryshimet legislative.

Në kuadër të programeve të Trajnimit për Trajnues, AD gjate vitit ka filluar të aplikojë një metodologji duke u mundësuar të gjithë te interesuarve në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial të shprehin interesin për pjesëmarrje në Trajnim për Trajnues. Permes webfaqes së AD-së është bërë shpallja dhe njoftimi në të gjitha faqet zyrtare të AD-së dhe në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë.

Është zhvilluar procesi i përzgjedhjes së kandidatëve. Për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të trajnimit, të gjitha trajnimet e trajnuesve gjatë vitit 2021 janë zhvilluar në bashkëpunim me donatorët e AD-së të cilët përveç mbështetjes teknike, kanë pasuruar trajnimet edhe me ekspert dhe trajnues ndërkombëtar, të cilët me përvojën dhe njohuritë e tyre ishin një aset i çmuar për trajnuesit vendorë të AD-së.

Gjatë vitit 2021 janë realizuar Trajnime për Trajnues në fushën komerciale, për mbrojtjen nga dhuna në familje, për parandalimin e torturës, financimin e terrorizmit, lirinë e shprehjes, për mos diskriminimin si dhe për evidencat penale.

Në fushën e drejtësisë komerciale- në kuadër të përgatitjeve të AD për implementimin e ligjit për gjykatën komerciale, në bashkëpunim dhe partneritet me Projektin e USAID-it për Drejtësi Komerciale, AD ka zhvilluar dhe finalizuar kurikulen trajnuese dhe trajnimin e 17 trajnuesve. Këta trajnues pas një trajnimi disa mujor nga projekti janë të gatshëm që të ofrojnë trajnime për gjyqtarët që do të emrohen në gjykatën komerciale. Vlene të theksohet se Drejtoresha e USAID në Washington ka përgëzuar dhe komplimentuar institucionet e Kosovës e me theks Akademinë e Drejtësisë për zhvillimin e kurikules trajnuese. Pra, fillimisht ka vazhduar procesi i rekrutimit të Trajnuesve i nisur që nga Nëntori i vitit 2020, në bashkëpunim me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), programi për Drejtësi Komerciale. Programi trajnues ishte i ndarë në 3 sesione trajnuese me nga 4 ditë, 2 prej të cilave u zhvilluan në Janar të vitit 2021 dhe tjetra në Mars 2021, dhe erdhi si rezultat dhe nevojë e procesit për Themelimin e Gjykatës Ekonomike në Kosovë. Pas përfundimit të trajnimit të trajnuesve, si pjesë e programit trajnues ishte edhe zhvillimi i pilot trajnimeve nga të gjithë kandidatët. U zhvilluan 10 pilot trajnime dhe u çertifikuan **17** kandidatë të rinjë, të specializuar në fushën komerciale, bankare, fiskale, të cilët do të jenë trajnues të ardhshëm brenda AD-së në fushën e të drejtës Ekonomike dhe Komerciale.

Nr.	Emërtimi i moduleve të zhvilluara
1.	Të drejtat e Pronësisë Intelektuale, market tregtare, patentat
2.	Specifikat e së drejtës Fiskale, Tatimore dhe Doganore
3.	Zbatimi dhe specifikat e direktivave të Be-së dhe rregulloreve ndërkombëtare në lidhje me çështjet komerciale, fiskale dhe doganore
4.	Përmbledhje e specifikave të industrisë së TIK-ut, licencimit dhe të drejtave të pronësisë
5.	Kuptimi i industrisë bankare, sigurimeve dhe institucioneve financiare
6.	Procedura e Përmbarimit, baza ligjore dhe mjetet juridike
7.	E drejta Kontraktuese, Kontrata e Ndërtimit
8.	Implikimet praktike të Ligjit për Shoqëritë Tregtare
9.	Vështrim i thelluar mbi procedurën e Falimentimit
10.	Arbitrazhi

Tabela nr. 9 me modulet e zhvilluara në fushën Komerciale

Lufta Kundër Dhunës ndaj Grave/Dhunës në Familje –është zhvilluar **1** trajnim i trajnuesve me 2 sesione. Të dy sesionet trajnuese janë zhvilluar në bashkëpunim me Këshillin e Evropës me ekspertin nga Kanadaja Eline Skinneder. Sesioni i parë i zhvilluar në Maj 2021, kishte për synim trajnimin e një grupi të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Si përfundim rezultoi me trajnimin e **5** gjyqtarëve dhe **5** prokurorëve të cilët janë si koordinator të veprave që kanë të bëjnë me dhunën në familje nëpër gjykata dhe prokurori. Sesioni i dytë u zhvillua në Qershor 2021 për zyrtarët e Qendrave për punë sociale si dhe organizatat joqeveritare të cilat merren me Dhunën ndaj grave/dhunën në familje. U trajnuan **14** pjesëmarrës duke përfshirë zyrtarë policor, zyrtarë nga QPS dhe zyrtarë të OJQ-ve. AD në fushën e Dhunës në Familje kishte vetëm **11** trajnues, kurse brenda vitit 2021 ka zgjeruar numrin e trajnuesve në këtë fushë në **24**.


Parandalimi i Torturës – Artikulli III i Konventës së Stambollit – është zhvilluar 1 trajnim i trajnuesve me 2 sesione trajnuese në bashkëpunim me projektin e Këshillit të Evropës Strengthening the Kosovo* Institutions in fight against torture, ill-treatment and other degrading treatment. Të dy sesionet e zhvilluara në Shtator dhe Tetor 2021, kishin pjesëmarrësit e njëjtë, 3 Prokurorë, 5 gjyqtarë, 3 zyrtarë nga Mekanizmi kombëtar për parandalim të torturës brenda zyrës së Avokatit të Popullit si dhe 3 zyrtarë nga Policia e Kosovës. Qëllimi i trajnimit ishte që të trajnohen një grup i caktuar i pjesëmarrësve duke i përfshirë të gjithë akterët të cilët janë në mënyrë direkte apo indirekte të përballur me rastet e torturës dhe formave tjera të keqtrajtimit. Kjo gjë edhe është arritur sepse parandalimi i torturës si temë e re e futur në programin trajnues nuk kishte asnjë trajnues të specializuar, e që tashmë i ka 14 trajnues potencial.

Financimi i Terrorizmit – është zhvilluar në bashkëpunim me Projektin e Këshillit të Evropës (Projekti kundër krimit ekonomik në Kosovë PECK III). Trajnimi i zhvilluar në 19-21 Tetor 2021 me pjesëmarrës nga institucione të ndryshme. Aset i shtuar i këtij trajnimi ishin 2 ekspertët ndërkombëtarë, gjyqtari nga Belgjika z. Theo Byl dhe ekspertja Arvinder Skindei. Pjesëmarrësit e trajnuar në këtë trajnim 3 ditor ishin Prokurorë nga Prokuroria Speciale, Gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, zyrtarë nga Njësia e Inteligjencës Financiare si dhe zyrtarë policor. Nga 5 trajnues sa kishte AD në fushën e Terrorizmit, me anë të këtij trajnimi, listës i'u shtuan edhe 16 të tjerë. Me këtë projekt, AD synon ta vazhdojë bashkëpunimin edhe gjatë vitit 2022 duke e zgjeruar fushën e trajnimit edhe në pjesën e Shpëlarjes së Parave.

Liria e Shprehjes – Neni 10 i KEDNJ – është vazhdimësi e bashkëpunimit të AD-së me projektin e JUFREX nga Këshilli i Evropës, bashkëpunim i zhvilluar që nga viti 2017. Ky trajnim 4 ditor i realizuar në muajin Tetor, ishte trajnimi më i pasur sa i përket numrit të ekspertëve të cilët me njohuritë e tyre e pasuruan trajnimin. Si trajnues ishin ekspertet ndërkombëtar dhe vendore duke përfshi znj. Mirela Bogdani nga Shqipëria, eksperti nga Italia z. Matthew Caruana Galizia, etj. Trajnimin e vijuan 5 gjyqtarë, 4 prokurorë si dhe 5 anëtarë nga Oda e Avokatëve. Qëllimi i trajnimit ishte që trajnuesit potencial në fushën e lirisë së shprehjes t'i përditësojnë njohuritë e tyre rreth risive legislative në fushën ndërkombëtare rreth Nenit 10 të KEDNJ, njohuri më të zgjeruara rreth padive SLAPP, formave të mbrojtjes së sinjalizuesve etj. Në fund u certifikuan 17 trajnues, të cilët AD mund t'i përdorë në të ardhmen si trajnues potencial.

Trajnim i Trajnuesve në fushën e Diskriminimit – është zhvilluar në bashkëpunim me OSCE, me ekspertet ndërkombëtare znj. Margarita Ilieva dhe Natia Katsitadze. Pjesëmarrës të trajnimit ishin 10 Gjyqtarë nga Gjykata e Apelit dhe Themelore nga regjione të ndryshme. Qëllimi i trajnimit ishte që trajnuesit potencial të AD-së në fushën e Diskriminimit të njoftohen më gjerësisht me format e diskriminimit dhe mënyrat e trajtimit të rasteve, krahasimet legislative mes Kosovës dhe të drejtës së BE-së, barra e provës në çështjet e diskriminimit etj. Nga 6 trajnues sa kishte AD në fushën e Diskriminimit, tani lista e tyre është pasuruar edhe me 10 trajnues të rinj.

Trajnim i Trajnuesve mbi Evidencat Penale – ishte trajnimi i fundit i trajnuesve i realizuar në dhjetor të vitit 2021. Ky trajnim u realizua në bashkëpunim me projektin National Centralised Criminal Record System (NCCR), duke përfshirë në vete një numër të madh të ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar. Pjesëmarrës të këtij trajnimi ishin 7 gjyqtarë dhe 4 prokurorë nga gjykatat dhe prokuroritë themelore nga regjionet e ndryshme duke e pasuar listën e trajnuesve në fushën e Evidencave Penale



Grafikoni nr. 17 të trajnuarit në Trajnimet për Trajnues

6. MËSIMI NË DISTANCË NËPËRMES PLATFORMËS E-LEARNING

Akademia e Drejtësisë përveç trajnimeve klasike, që nga viti 2011 ka zhvilluar edhe platformën e mësimit në distancë E-learning. Kjo platformë është krijuar me qëllim të lehtësimit të marrjes së informacionit dhe çasjes më të lehtë për tema të ndryshme për përfituesit e saj (Gjyqtarë, Prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive) etj.

Platforma E-learning gjatë vitit 2021 është pasuruar me 3 kurse të reja, të zhvilluara në bashkëpunim me organizatën joqeveritare “INJECT”. Këto kurse ishin të fokusuar në fushën e dhunës ekonomike dhe formave të ndarjes së bashkëshortëve, tema të cilat janë pak të trajtuara. Gjatë periudhës sa ishin online, në këto kurse u certifikuan 5 Gjyqtarë dhe 1 Prokurorë.

Gjithashtu në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, AD ka zhvilluar 2 kurse tjera në platformën e KiE, (platforma HELP), në fushën e Dhunës në familje dhe në fushën e Parandalimit të Torturës. Përfitues të këtyre kurseve ishin 21 student të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës si dhe 41 gjyqtarë, prokurorë.

Gjatë vitit 2021 janë zhvilluar edhe 2 kurse tjera, njëra në bashkëpunim me projektin e “IPR – Intellectual Property Rights” në fushën e Markave Tregtare, Dizajnit Industrial dhe Markave Tregtare, dhe kursi tjetër i zhvilluar nga Trajnuesi i Përhershëm brenda Akademisë së Drejtësisë me temë “Paraburgimi”.

Me qëllim të avansimit dhe ofrimit të kurseve sa më profesionale, Akademia e Drejtësisë ka filluar procesin e kalimit dhe ndryshimit të platformës E-learning nga platforma aktuale ILIAS, në platformën MOODLE. Ky ndryshim është duke u bërë në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë, e cila ka shprehur gatishmërinë që ta ndihmojë AD-në në zhvillimin e softwarit si dhe ofrimin e kurseve të tyre nga platforma HELP, me qëllim të pasurimit të platformës së AD-së me kurse të reja dhe profesionale. Kjo është edhe arsyeja që 2 kurset e zhvilluara në fushën e markave tregtare dhe paraburgimit nuk janë integruar ende në platformë, deri sa të bëhet tërësisht ndryshimi i platformës dhe të adaptohen kurset sipas kërkesave teknike të platformës Moodle.

Më tërë këto ndryshime, Akademia e Drejtësisë synon që platformën e saj elektronike E-learning ta bëjë një burim të rëndësishëm të informacionit, duke e pasuruar dhe zhvilluar sipas metodave më

të avansuara, me qëllim që përfituesve të saj të ju ofrohen kurse profesionale dhe të nevojshme në ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

Në kuadër të platformës së mësimin në distancë E-learning, janë ofruar këto kurse trajnuese:


1. Dhuna Ekonomike;
2. Mbajtja financiare dhe Alimentacioni;
3. Ndarja e pasurisë së përbashkët mes bashkëshortëve.

Kurse të zhvilluara në platformën e Këshillit të Evropës HELP:

1. Parandalimi i Torturës dhe formave tjera degraduese;
2. Lufta ndaj dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje.

Kurset që janë zhvilluar dhe që pritet të integrohen pas kalimit në platformën MOODLE:

1. Markat Tregtare, Patentat, Dizajni Industrial;
2. Paraburgimi.



Grafikoni nr.18 me Kurset në platformën E-learning dhe numrin e Pjesëmarrësve në vitin 2021

7. PROGRAMI PËR HULUMTIME DHE PUBLIKIME (PHP)

Ngritja e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve, prokurorëve si dhe përfituesve tjerë sipas ligjit të AD-së bëhet edhe përmes vlerësimit të nevojave trajnuese dhe zhvillimit të programeve trajnuese adekuate. Gjithashtu krahas burimeve primare për lehtësimin e procesit të bërjes së drejtësisë edhe përmes krijimit mjeteve juridike dhe ofrimit të burimeve të cilat realizohen përmes Programit për Hulumtime dhe Publikime.

Pra, për zhvillimin profesional ky program kryen analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Në kuadër të PHP-së janë zhvilluar aktivitete të cilat kanë qenë të orientuara në drejtim të:

- Zbatimit të procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe përpunimit të dhënave për hartimin e Programit Trajnues për vitin 2022;

- Veprimtarisë botuese me theks te zhvillimi i moduleve trajnuese për zbatimin e programeve të AD-së;
- Ofritit të burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së;
- Aktiviteteve në procesin e planifikimeve institucionale në zbatim të masave dhe politikave euro integruese si dhe
- Menaxhimit të koleksioneve të bibliotekës dhe abonimit në data baza elektronike.
- Përditësimit të statistikave dhe data bazës me aktivitetet e realizuara gjatë vitit në kuadër të programeve trajnuese të AD-së.

7.1. Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese

Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë vëmendje të veçantë i ka kushtuar vlerësimit të nevojave trajnuese, meqë nga rezultatet dhe të gjeturat nga ky proces, përfshirë edhe zhvillimi i metodologjisë trajnuese janë përcaktuese për kurrikulën trajnuese të radhës. Në këtë vështrim, procesi për vlerësimin e nevojave trajnuese është realizuar duke i zbatuar me efikasitet mekanizmat për vlerësim gjatë gjithë vitit duke analizuar gjitha burimet e informacionit dhe zhvillimet e reja në gjyqësor. Pra, në funksion të vlerësimit të nevojave trajnuese në periudhën raportuese janë zhvilluar këto aktivitete:

- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga analiza e formularëve të vlerësimit pas secilit sesion trajnues deri në fund të vitit 2021;
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga pyetëtorët për gjyqtarë dhe prokurorë
- Identifikimi i nevojave trajnuese përmes realizimit të takimeve me trajnues të AD-së, kryetarë të gjykatave, gjyqtarë mbikëqyrës si dhe përfaqësues nga KGJK dhe KPK
- Shqyrtimi i propozimeve dhe rekomandimeve nga dokumentet strategjike të cilat kanë relevancë për gjyqësorin duke përfshirë edhe raportin e BE-së për Kosovën dhe kërkesat e MSA-së.
- Shqyrtimi i portaleve të gjykatave dhe prokurorive duke marrë për bazë edhe raportet e punës së tyre;
- Për çështje krahasimore janë shqyrtuar edhe programet trajnuese të institucioneve trajnuese rajonale si dhe
- Në vazhdimësi është përcjellë agjenda legjislative në kuvend si dhe mediat dhe portalet të cilat kanë pasur në fokus gjyqësorin e Kosovës.

Mbledhja dhe përpunimi i këtyre të dhënave nga këto burime është finalizuar me *Raportin analizë nga vlerësimi i nevojave trajnuese për vitin 2022* i cili më pas i ka kontribuar hartimit të Programit trajnues për vitin 2022.

7.2 Veprimtaria botuese

Komponentë e rëndësishme e Programit për Hulumtime dhe Publikime është edhe veprimtaria botuese. Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë është angazhuar në procesin e nxjerrjes dhe shtypjes së botimeve duke qenë në kontakt dhe monitoruar procesin deri në finalizimin e tyre. Gjatë vitit 2021 për nevoja të funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së AD-së janë realizuar publikimet si në vijim:

- Plani i punës për vitin 2021 i AD-së
- Raporti vjetor i AD-së për vitin 2020
- Programi i Trajnimit për vitin 2022
- Programi i Trajnimit Fillestar- Për nevojat e zbatimit të Programit të Trajnimit fillestar janë realizuar edhe 6 modulet trajnuese për 24 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së VIII konform këtij programi të cilat përfshijnë aspektin profesional dhe interdisciplinar.

Ndërsa në bashkëpunim dhe në partneritet me donatorët AD ka publikuar dhe ka inkorporuar në materialet trajnuese publikimet si në vijim:

- Manuali për gjyqtarë për procedurën e falimentimit
- Manuali për administratorë për procedurën e falimentimit
- Manual Trajnimi për Trajnerë për Prokurorë dhe Gjyqtarë: Parandalimi dhe luftimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
- Kurrikula model mbi Protokollin e Stambollit - Hetimi dhe Dokumentimi Efektiv i Torturës dhe Keqtrajtimit
- Material Burimor për prokurorët dhe gjyqtarët në luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
- Modul trajnimi për gjyqtarë dhe prokurorë-Situata dhe trajtimi i rasteve të abuzimit ekonomik të fëmijëve
- Udhëzues për procedurat dhe mënyrën e trajtimit të viktimave të krimit
- Moduli i trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive –aspekti penal, material dhe procedural
- Moduli i trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive –aspekti civil, material dhe procedural
- Procedurat Standarde të veprimit për hetimin dhe gjykimin e rasteve të shfrytëzimit të fëmijëve në forma të rrezikshme të punës

Kjo komponentë pra, veçanërisht publikimet që kanë karakter udhëzues për gjyqtarët dhe prokurorët, përfshirë edhe profesionistët e tjerë ligjor janë mbështetur nga projektet me donatorë si UNDP dhe SAEK (Manuali i trajnimit bazik për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor), Këshilli i Evropës (Manual Trajnimi për Trajnerë për Prokurorë dhe Gjyqtarë, Parandalimi dhe luftimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Kurrikula model mbi Protokollin e Stambollit - Hetimi dhe Dokumentimi Efektiv i Torturës dhe Keqtrajtimit si dhe Material Burimor për prokurorët dhe gjyqtarët në luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje). ILO (Organizata ndërkombëtare e Punës) me publikimin: Procedurat Standarde të veprimit për hetimin dhe gjykimin e rasteve të shfrytëzimit të fëmijëve në forma të rrezikshme të punës, GIZ me Udhëzuesin për procedurat dhe mënyrën e trajtimit të viktimave të krimit si dhe IFC dhe USAID me Manualët për procedurën e falimentimit qoftë për gjyqtarë ashtu edhe për administratorë falimentues.

Me rastin e botimit të këtyre materialeve janë realizuar 3 ceremoni të veçanta publikimi dhe pranimi nga ana e AD-së. Ekzemplarët e shtypur nga botimet e lartpërmendura janë shpërndarë tek përfituesit e AD-së me theks te gjyqtarët, prokurorët si dhe profesionistët ligjor që puna e tyre lidhet me përmbajtjen që ofrojnë botimet përkatëse.

7.3 Menaxhimi i koleksioneve të bibliotekës së AD-së

Biblioteka ligjore e Akademisë së Drejtësisë ka vazhduar të jetë një burim kryesor i materialit hulumtues ligjor e cila ka qenë në funksion të përfituesve të saj gjatë gjithë vitit. Kjo bibliotekë operon përmes dy platformave: sistemi KOHA e cila ofron katalogun e titujve që posedon biblioteka në kopje fizike si dhe e bibliotekën e cila ofron formatin elektronik të burimeve dhe materialeve ligjore. Në periudhën raportuese për shkak të rrethanave pandemike janë ofruar materiale ligjore kryesisht nga biblioteka elektronike. Në funksion të ofrimit të shërbimeve dhe përmbushjes së kërkesave edhe menaxhimi i koleksioneve të kësaj biblioteke ka qenë prioritet gjatë gjithë kohës. Në këtë drejtim është përditësuar dhe monitoruar në vazhdimësi qarkullimi i resurseve të saj, është vazhduar me regjistrimin e materialeve të reja ligjore dhe varësisht prej kërkesave qoftë kopjeve fizike ashtu edhe ato elektronike janë ofruar shërbime për përfituesit e saj.

Biblioteka ligjore e AD-së në periudhën raportuese është pasuruar edhe më tej me botimet e theksuara në këtë raport e gjithashtu edhe nga donacionet si nga Organizata Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut Civil Rights Defenders nga GIZ, JUFREX dhe organizata tjera të cilat me punën e tyre ndihmojnë sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

7.4 Qasja në burime ligjore në data bazat ndërkombëtare

Akademia e Drejtësisë ka vazhduar anëtarësimin në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës (ABEK) me qëllim që përfituesve të saj t’u ofrojë resurse dhe burime ligjore edhe nga rrafshi ndërkombëtarë. Për këtë anëtarësim AD në baza vjetore paguan shumën prej 200 eurove. Përmes këtij anëtarësimi, Akademia ka siguruar qasjen në disa data baza të natyrës ligjore dhe të përgjithshme që konzorciumi i EIFL-as i siguron për vendet në tranzicion. Bazuar në të dhënat e administruesve të faqes së AD-së nuk mund të dihen saktë numri i përdoruesve të databazave por vetëm të faqes së AD-së në kuadër të cilave janë të qasshme databazat. Numri i përdoruesve të faqes së AD-së v varion dikund rreth 1550 në muaj.

Qasja në këto data baza ndryshon nga viti në vit, ndërkaq për vitin 2021 ka qenë e abonuar në këto data baza:

ASTM Compass Cambridge Journals Online	ASTM International Cambridge University Press
Cambridge Journals Online	Duke University Press
e-Duke Journals Scholarly Collection	Edward Elgar Publishing
Edward Elgar Publishing Journals and Development Studies e-books	IMF Publication
IMF eLibrary	IOP Publishing
IOP science	Open Edition
Open Edition Journals	

Tabela nr. 10 abonimi në databazat elektronike përmes ABEK

7.5 Përditësimi i statistikave dhe data bazës së të dhëna me aktivitetet e realizuara gjatë vitit në kuadër të programeve trajnuese të AD-së

Statistikat janë komponentë e rëndësishme e PHP-së në kuadër të cilit vepron dhe funksionon kjo njësi. Përditësimi dhe vendosja e të dhënave në data bazë ka kontribuar në ofrimin e të dhënave për aktivitetet trajnuese të vijuar nga gjyqtarët dhe prokurorët në përmbushje të rregulloreve të KGJK-së dhe KPK-së, për nevojat e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, për procese të rëndësishme në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, për profesionistët tjerë ligjor si dhe për nevojat e raportimit në mekanizmat euro integruar. Statistikat më tej kanë shërbyer në përgatitjen e raporteve periodike të cilat prezantojnë aktivitetet dhe veprimtarinë e AD-së. Në periudhën raportuese data baza është zhvilluar edhe më tej duke mundësuar gjenerimin e të dhënave shumë saktë dhe shpejtë për çështje të rëndësishme në sferën e trajnimeve.

8. BASHKPUNIMI ME DONATORË DHE PROJEKTE NDËRKOMBËTARE - PUNËTORI, TRYEZA PUNE DHE AKTIVITETE TJERA

Në periudhën raportuese, AD-së nuk i ka munguar bashkëpunimi ndërkombëtar si dhe asistencë dhe mbështetja nga donatorët. Pavarësisht rrethanave të shkaktuara nga pandemia COVID 19, në sajë të këtij bashkëpunimi AD ka përfituar mbështetje në realizim të trajnimeve, punëtorive dhe tryezave të shumta si dhe pjesëmarrje në konferenca dhe forume të ndryshme ndërkombëtare. Këto aktivitete kishin synim ngritjen e kapaciteteve profesionale në luftimin dhe parandalimin e dhunës në Familje, krimin të organizuar dhe korrupsionit, pastrimit të parave, fuqizimit të drejtësisë komerciale, mbrojtjes së të drejtave të njeiut si dhe zbatimin e praktikave më të mira në zgjidhjen e çështjeve ligjore përkatëse. Nga këto aktivitete kanë përfituar gjyqtarë, prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive si dhe profesionistë tjerë ligjor. Këto aktivitete janë mbështetur nga Këshilli i Evropës, OPDAT-Ambasada Amerikane, zyra e BE-së në Prishtinë si dhe nga organizata të ndryshme ndërkombëtare që kanë në fokus mbështetjen e trajnimit gjyqësor. Në vijim për secilën nga këto bashkëpunime jepen detaje të hollësishme për numrin e aktiviteve dhe të dhëna tjera të rëndësishme:

8.1 Aktivitetet e realizuara me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-së OPDAT - Ambasadën Amerikane

Gjatë vitit 2021, si rezultat i bashkëpunimit me Departamentin Amerikan të Drejtësisë/OPDAT, janë realizuar tri (3) tryeza për prokurorë me temë: “Shtjellim i koncepteve kryesore të Udhëzuesit të KPSH-së mbi rolin dhe kontributin e prokurorit të shtetit në matjen e dënimit”. Këto tryeza u realizuan në tri regjione Prishtinë, Mitrovicë dhe në Ferizaj për të mundësuar pjesëmarrjen e pothuajse gjithë prokurorëve të shtetit. Qëllimi i këtyre tryezave ishte paraqitja e udhëzimeve të cilët duhet ndjekur nga prokurorët e shtetit në fazën fillestare të fillimit të procedurës penale për të avancuar politikën ndëshkimore në vend. Nga këto tryeza kanë përfituar prokurorë nga Prokuroria Speciale si dhe prokurorë nga niveli themelor nga gjitha regjionet e Kosovës.

8.2 Aktivitetet e realizuara me Ambasadën Amerikane në Zagreb

Në periudhën raportuese përmes Ambasadës Amerikane në Zagreb është mundësuar pjesëmarrja e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës në tri (3) aktivitete trajnuese. Aktiviteti i parë ishte webinar regjional lidhur me provat elektronike, i dyti për kriptovalutat dhe i fundit ishte i fokusuar në efikasitetin egjyqësor-gjykimet e vazhdueshme dhe praktikat më të mira për të adresuar vonesat e gjykimeve.

8.3 Aktivitetet e realizuara me programet e USAID

AD në bashkëpunim me Projektin për Drejtësi Koerciale— ka realizuar trembëdhjetë (13) aktivitete të cilat kanë përfshirë punëtori, tryeza, trajnim të trajnuesve në fushën e drejtësisë komerciale. Në këto aktivitete trajnuese janë trajtuar çshtje nga ndërmjetësimi, nga pronësia intelektuale, markat tregtare dhe patenatat, arbitrazhi, specifikat e së drejtës fiskale, tatimore dhe doganore, instrumentet ndërkombëtare mbi çështjet fiskale dhe doganore, kontratat e ndërtimit, zgjidhja e mjeteve juridike në procedurën përmbarimore dhe llogaridhënia e përmbaruesve privat, shoqëritë tregtare dhe për procedurën e falimentimit.

Me projektin “Justice Activity in Kosovo”, është realizuar vlerësimi i nevojave të zyrtarëve të ndihmës juridike falas dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të cilët me aktivitetet e tyre ofrojnë ndihmë juridike falas. Në kuadër të këtij procesi janë zhvilluar pyetësorët përmes platformës Survey monkey, janë realizuar takime të përbashkëta të cilat kanë pasur si qëllim përmirësimin e shërbimeve të ndihmës juridike. Nga rezultatet dhe diskutimet e përbashkëta ka rezultuar zhvillimi i një doracku i cili ofron më të mira në këtë fushë.

8.4 Aktivitetet e realizuara me zyrën e Bashkimit Evropian dhe projektet e saj

Me projektin e Kodit Civil-faza e II janë realizuar gjashtë (6) aktivitete trajnuese të cilat kishin synim trajtimin e risive ligjore që sjellë Projekt Kodi Civil i cili pritet të hyjë në fuqi së shpejti. Në kuadrin e këtyre aktiviteteve trajnuese janë trajtuar risitë ligjore në çështjet civile familjare, çështjet pronësore, në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe aspekte tjera të përgjithshme të së drejtës civile. Në këto aktivitete trajnuese kanë përfituar gjyqtarë nga divizioni civil nga gjitha gjykatat e Kosovës.

Me projektin EUKOJUST janë realizuar aktivitete në dobi të zhvillimit të kapaciteteve të stafit të AD-së në menaxhimin dhe organizimin e punës, kapaciteteve të AD- duke filluar nga vlerësimi për legjislacionin aktual të AD-së dhe plotësimet për aktet nënligjore të brendshme të AD-së, vlerësimin e ndërtesës së re të Akademisë së Drejtësisë në aspektin e nevojave për hapësirë dhe funksionalitet lidhur me infrastrukturën e TIK, të cilat kanë synuar një organizim më funksional të AD-së si dhe shfrytëzim më të mirë të hapësirës së objektit të ri.

Me projektin National Centralized Crminal Record System (NCCR) AD gjatë vitit 2021 ka qenë e përkushtuar në fuqizimin e kapaciteteve të trajnuesve të AD-së në fusha specifike. Në këtë kuadër në saje të bashkëpunimit me NCCR ka realizuar trajnimin e trajnuesve rreth evidencës penale. Qëllimi i këtij trajnimi ishte që të krijojë një grup trajnuesish që në të ardhmen të jenë në

gjendje të zhvillojnë trajnime më të avancuara rreth Evidencave Penale si dhe të ofrohen sqarime më të hollësishme rreth kornizës ligjore për rehabilitimin e personave të dënuar/shlyerja dhe pasojat juridike të dënimit, organizimi dhe funksionimi i SQEPK, llojet e të dhënave në sistem etj. Poashtu është është trajtuar edhe Rregullorja e KGJK-së dhe parimet kryesore, si dhe krahasimi i Sistemit evropian të informacioneve për evidencën penale.

8.5 Aktivitetet me Bankën Botërore

Me projektin e Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO) janë realizuar dy (2) punëtori të cilat kishin në fokus hatimin e procedurave standarde të veprimit për hetimin e rasteve të punës së rëndë të fëmijëve. Këto procedura standarde më tej do të shërbejnë për gjykimin e drejtë të rasteve përkatëse në praktikë nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

8.6 Aktivitetet e realizuara me zyrën e Këshillit të Evropës dhe projektet e saj

Në periudhën raportuese, Këshilli i Evropës në Prishtinë përmes projekteve të saj ka realizuar gjithësejt dymbëdhjetë (12) aktivitete trajnuese. **Projektet “PECK III”, “Forcimi i institucioneve të Kosovës në luftën kundër torturës, keqtrajtimit dhe trajtimeve tjera degraduese”, “JUFREX”, “iPROCEEDS”, “Fuqizimi i luftës kundër grave dhe dhunës në familje në Kosovë -Faza II”** kanë ndihmuar AD-në në ofrimin e trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë për ngritjen e kapaciteteve profesionale në luftimin kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, ndalimit të torturës dhe formave tjera denigruese, në mbrojtjen e gazetarëve dhe sinjalizuesve, për qasjen në dokumentet publike si dhe në luftimin e krimit kibernetik dhe financimin e terrorizmit.

Këto projekte kanë mbështetur përveq tjerash edhe ngritjen e kapaciteteve trajnuese të AD-së duke ofruar tranime të trajnuesve për aspektet e lartpërmendura. Gjithashtu AD është mbështetur edhe me punëtorinë për hartimin e Programit trajnues për vitin 2022. Në total janë gjithësejt 12 aktivitete trajnuese.

8.7 Aktivitetet e realizuara me projektin “Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosove” të financuar nga Ambasada Britanike

Gjatë vitit 2021, AD në mbështetje të projektit projektin “Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosove” ka realizuar katër (4) aktivitete trajnuese të cilat ishin të orientuara për menaxhimin e rasteve në gjykata dhe prokurori si dhe për çështjet që kanë të bëjnë me mentorimin dhe procese objektive, transparente, gjithëpërfshirëse dhe jo diskriminuese dhe g të bazuar në merita për rastet e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve. Në këto aktivitete trajnuese kanë vijuar gjyqtarë, prokurorë, asministratorë dhe profesionistë tjerë ligjor të gjykatave dhe prokurorive të Kosovës.

8.8 Aktivitetet e realizuara me OSBE-në

Në kuadër të bashkëpunimit me OSBE-në, AD ka realizuar gjashtë (6) aktivitete, përkatësisht punëtori, trajnim të trajnuesve dhe forma tjera të trajnimit në të cilat kanë përfituar gjyqtarë, prokurorë si dhe profesionistë tjerë ligjor nga sistemi gjyqësor dhe prokurorial. Fushat në të cilat janë përqendruar aktivitetet përkatëse kishin të bënin me krimin e organizuar dhe korrupsionin, të drejtën për barazi dhe mosdiskriminim, procedurën penale të kryesve me çrregullime mendore, unifikimin e praktikës gjyqësore në çështje penale si dhe në zbatim të KEDNJ-së dhe Jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykatat e Kosovës. Poashtu OSBE ka ndihmuar në përkthimin në serbisht të Modulit për trajnimin bazik të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive-aspekti penal.

8.9 Aktivitetet e realizuara me GIZ- “Projekti për Reformë Ligjore dhe Administrative”

Për vite me radhë GIZ dhe projektet e saj kanë ndihmuar AD-në në fuqizimin dhe përmbushjen e mandatit të saj ligjor, përkatësisht në ofrimin dhe zbatimin e programeve trajnuese jo vetëm për gjyqtarë dhe prokurorë por edhe për profesionet e tjera të lira. Në periudhën raportuese, në bashkëpunim me GIZ janë realizuar shtatë (7) aktivitete trajnuese. Në kaudër të këtyre aktiviteteve trajnuese janë trajtuar: Procedura “Procedura gjyqësore ne rastet e mbrojtjes nga dhuna në familje”, “Provat në procedurë penale dhe ligjshmëria e tyre”, “Zhvillimi i ankandëve në procedurën përmbarimore”, “Procedura kundërvajtësve sipas kërkesës së inspektoreve”, “Përmbarimi në sendet e paluajtshme”, “E Drejta Sendore- Çështjet pronësore” si dhe “Barazia gjinore në çështje pronësore të pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve”. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të përfituesve sipas ligjit që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe elaborimit të rasteve nga praktika gjyqësore të ngriten kapacitetet profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, përmbaruesve privat, zyrtarëve të ndihmës juridike falas dhe profesionistëve tjerë ligjor për zgjidhjen e drejtë të rasteve ligjore përkatëse.

8.10 Aktivitetet e realizuara me UNDP dhe SAEK

Në periudhën raportuese, AD në bashkëpunim me UNDP ka realizuar gjashtë (6) aktivitete trajnuese të cilat i janë dedikuar gjyqtarëve, prokurorëve si dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Në kuadrin e trajnimeve janë trajtuar: “Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor”, “Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun”, “Intergriteti dhe sjelljet etike”, “Aspekti material dhe procedural i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi (me tej në tekst LMD) dhe sfidat në zbatimin e tij”, “Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun”, “Program i Specializuar Trajnimi Krimi Kibernetik Sesioni II” si dhe ‘Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin prokurorial. Qëllimi i këtyre aktiviteteve trajnuese ishte avancimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve në zgjidhjen ligjore të rasteve që kanë të bëjnë me krimin kibernetik si dhe në luftimin e diskriminimit. Ndërkaq në aktivitetet dedikuar stafit administrativ ishte ngritja e efikasitetit të punës në gjykata dhe prokurori përmes përmirësimit të shërbimeve nga stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial duke zbatuar praktikat më të mira të menaxhimit të dosjeve dhe lëndëve, sjelljeve etike dhe komunikimit adekuat me publikun.

Përveq aspektit të trajnimeve, UNDP ka kontribuar edhe në zhvillimin e modulit të trajnimit bazik për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive i cili përfshinë çështje ligjore nga fusha penale dhe civile si në aspektin material ashtu edhe procedural. Projekti i SAEK ka kontribuar në zhvillimin e modulit sa i përket fushës penale, me theks te veprat

penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga modulet pritjet me fillim të vitit 2022 një pjesë e së cilës do të vazhdojë të mbështetet nga UNDP. Përveq zhvillimit të modulit në fushën penale projekti SAEK, UNDP dhe Institutin e Bazelit ka ndihmuar edhe në realizimin e trajnimit me temë: “Kriptoalutat dhe Pastrimi i Parave”.

Akademia e Drejtësisë në sajë të bashkëpunimit me UNDP ka marrë pjesë edhe në Konferencën virtuale të lansimit të Raportit Global të Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2020”, aktivitetet i cili është realizuar nga Ambasada e Suedisë në Kosovë.

8.11 Aktivitetet e realizuara me UNCHR-Zyra e Misionit në Kosovë

Gjatë vitit 2021 në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me UNCHR, Drejtori Ekzekutiv i AD-së ka marrë pjesë në “Forum ligjor mbi aspektet thelbësore të mbrojtjes së Konventës së refugjatëve të vitit 1951 nga perspektiva e të drejtave të njeriut”. Gjithashtu është realizuar edhe një trajnim për gjyqtarët e departementit administrativ me temë: E drejta e Azilit dhe legjislacioni në fuqi.

8.12 Aktivitetet e realizuara me Grupin e bankës botërore, mbështetur nga Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO)

Në kuadër të bashkëpunimit me këtë organizatë janë hartuar dy manuale që i kontribuojnë procesit të punës së gjyqtarëve dhe administratorëve falimentues për gjykimin e rasteve të falimentimit.. Përveq kontributit në hartimin e këtyre manualeve poashtu janë shtypur ekzemplarët në sasi që plotësojnë nevojat për gjyqtarët dhe administratorët falimentues. Më tej është realizuar edhe Ceremonia e publikimit të dy manualeve: “Manualin për procedurën e falimentimit për gjyqtarë” si dhe “Manualin për procedurën e falimentimit për administrator falimentues” në kuadër të cilit kanë marrë pjesë gjyqtarë dhe administratorë falimentues.

8.13 Aktivitetet e realizuara me Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim-ATRC

Në bashkëpunim me ATRC, AD ka realizuar dy (2) aktivitete trajnuese me temë: “Krimet e urrejtjes”. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte ngritja e kapaciteteve të prokurorëve për ndjekjen e veprave penale të kryera nga urrejtja dhe të gjyqtarëve për ndëshkimin e këtyre rasteve si dhe zbatimi i drejtë i kornizës ligjore vendore dhe standardeve ndërkombëtare në këto raste. Fokusi në këto trajnime ishte në nxitjen dhe reagimin institucional ndaj krimeve të urrejtjes duke vënë në pah trajtimin efikas të këtyre dhe zbatimin e praktikave më të mira që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes. Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtarë, prokurorë si dhe bashkëpunëtorë profesional nga Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës.

8.14 Aktivitetet e realizuara me EULEX dhe organizatat tjera (IRZ, EIPA, CEL dhe INJECT)

Në periudhën raportuese, AD në bashkëpunim me EULEX ka realizuar një trajnim me temë: “Unifikimi i praktikave të prokurorisë në aplikimin e Ligjit të ri për të Mitur” . Në saje të mbështetjes nga IRZ është realizuar trajnimi me temë: “Zbatimi në praktikë i Ligjit për Shoqëritë Tregtare”. Nga bashkëpunimi me Institutin Evropian të Administratës Publike - EIPA Luxemburg është realizuar trajnimi me temë: “E drejta e Bshkimit Evropian”, ndërkaq sa i përket luftimit të diskriminimit me CEL - Qendra për Barazi dhe Liri për të drejtat e komunitetit LGBTI është realizuar trajnimi me temë: “Avancim mbi të drejtat e personave LGBTI në Kosovë” si dhe me Iniciativën për Drejtësi dhe Barazi – INJECT” trajnimi me temë “Dhuna Ekonomike”. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte fuqizimi i kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjykimin e drejtë rasteve duke zbatuar legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.

8.15 Aktivitetet me Rrjetin Evropian të Trajnimit Gjyqësor (EJTN)

Gjatë vitit 2021, Akademia e Drejtësisë përmes pikës kombëtare të EJTN-it është njoftuar për të gjitha aktivitetet trajnuese të planifikuara, në programin e trajnimeve të vazhdueshme dhe në programet e shkëmbimit, qoftë ato të përgjithshme apo edhe ato të AIAKOS 2021 për gjyqtarët e me mandat të ri. Lidhur me këto mundësi, përfituesit e Akademisë së Drejtësisë, përkatësisht gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës janë informuar përmes postimit të njoftimeve dhe kalendarit të aktiviteteve në ueb faqen zyrtare të AD-së (rubrikën e posaçme për EJTN), si dhe në faqet sociale si LinkedIn dhe Facebook.

Duke qenë se, Marrëveshja për Grant me DG NEAR nuk ishte në dispozicion për këtë vit për të financuar pjesëmarrjen fizike të të interesuarve nga Kosova, Akademia megjithatë ka pasur mundësinë që të regjistrojë pjesëmarrës në aktivitetet trajnuese me kyçje online.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, në Programin e Shkëmbimit AIAKOS 2021, Akademia ka regjistruar dhe kanë marrë pjesë dy gjyqtare (me mandat të ri) nga Kosova, të cilat vijuan trajnimin online, të cilat programe u realizuan nga institucionet nikoqire në Rumani dhe në Holandë gjatë muajit nëntor 2021, respektivisht në datat 15-20 Nëntor 2021.

9. Programi për praktikantë dhe studentë

Në periudhën raportuese, për shkak të situatës me COVID 19 dhe pamundësisë së shtimit të numrit të stafit ka pasur vetëm një praktikantë studentë nga UBT i cili ka ndjekë programin praktikës për tre muaj. Ndërkaq nga projektet me donatorë kanë vijuar programin e praktikës edhe dy (2) praktikantë për periudhë gjashtë mujore. Këta praktikantë janë mbështetur nga projekti i USAID-it për Drejtësi Komerciale. Të tre praktikantët e kanë përfunduar me sukses programin e praktikës duke pasur mundësinë edhe të përfitimit nga pjesëmarrja në trajnimet e Akademisë si dhe në përgatitjen e trajnimeve dhe raporteve për aktivitetet e organizuara nga Akademia e Drejtësisë.

10. ADMINISTRATA DHE FINANCAT

Departamenti i Administratës dhe Financave (më tej DAF) udhëhiqet nga Drejtori për Administratë dhe Financa, i cili është nivel drejtues dhe përfshinë sektorë të cilët janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të përgjithshme si financiare, të prokurimit, teknologjisë informative, personelit dhe logjistikës, në funksion të realizimit të objektivave programore të Akademisë.

Përgjegjësitë kryesore të DAF janë të përcaktuar me rregulloren për organizim të brendshëm dhe janë si në vijim:

- Përcaktimi i politikave dhe objektivave për zhvillimin dhe zbatimin e procedurave standarde në lidhje me buxhetin dhe financat, burimet njerëzore, prokurimin, teknologjinë informative, logjistikën dhe arkivin e Akademisë;
- Menaxhimi dhe koordinimi i procesit për ofrimin e shërbimeve administrative dhe financiare që kanë të bëjnë me funksionet dhe aktivitetet e Akademisë;
- Zhvillimin e një administrate profesionale, efikase, funksionale për ofrimin e shërbimeve administrative, në përputhje me nevojat dhe specifikat e Akademisë;
- Planifikimin, hartimin, raportimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e buxhetit dhe financave të Akademisë;
- Zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë kompetencat e departamentit;
- Planifikimin, koordinimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit në Akademi në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin në fuqi;
- Propozimin e akteve normative për funksionimin e departamentit;
- Planifikimin, mbikëqyrjen dhe administrimin me pajisjet e teknologjisë informative, programet softuerike dhe sistemet e rrjetit telekomunikues, të cilat janë pronë e Akademisë;
- Planifikimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin me pasurinë e Akademisë;
- Ofrimin e shërbimeve logjistike ku përfshihet furnizimi me mallra, shërbimet e transportit, mirëmbajtja e objektit dhe arkivi i Akademisë si dhe
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet relevante për zbatimin e legjislacionit në kuadër të funksioneve të departamentit.

10.1 Shërbimet e përgjithshme

Në kuadrin e shërbimeve të përgjithshme, në periudhën raportuese në aspektin administrativ, teknik dhe të logjistikës janë mbështetur të gjitha aktivitetet e organizuar nga AD. Varësisht nga aktivitetet trajnuese është bërë arkivimi i materialit trajnues për qëllime studimi. Gjithashu përfunduar auditimi nga ZKA për vitin 2020 dhe është publikuar raporti i auditimit si dhe përgatitur plani për zbatimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2020.

10.2 Burimet njerëzore

Pavarësisht kërkesave për rregullimin e statusit të të punësuarve në AD, përshtatshmërisht me statusin e të punësuarve në administratën sekretariateve të KGJK-së dhe KPK-së, të punësuarit në Akademi të Drejtësisë janë shërbyes civil dhe i nënshtrohen ligjeve dhe rregullave për shërbimin civil në Kosovë. Në pajtim me këto rregulla të punësuarit në Akademi janë në marrëdhënie pune me akt emërimi prej kur ka filluar të zbatohet ky sistem.

Stafi i AD-së paraqesin resursin më të rëndësishëm përderisa është i angazhuar me zbatimin e programeve trajnuese, në analiza hulumtime dhe veprimtari botuese si dhe me shërbime tjera të cilat janë në funksion të ngritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistë tjerë ligjor. Pavarësisht mungesave të stafit objektivat janë arritur për vitin 2021. Një pjesë e stafit përveq punëve që parashihen me rregullore kryen edhe punë tjera shtesë me theks te veçantë zyrtari për zotim të mjeteve buxhetore, kryen punën e zyrtarit të pasurisë si punë shtesë, zyrtarja e lartë për përkthime kryen punë të zyrtarit për shpenzime dhe zyrtarit për ekzekutim dhe përfaqësim. Gjithashtu zyrtari për statistika kryen punë edhe të zyrtarit certifikues.

Numri i aprovuar i stafit me buxhetin e vitit 2021, ka qenë 32 pozita, ndërsa numri i stafit në fund të vitit ka qenë 26 zyrtar. Gjatë vitit 2021, një zyrtar ka arritur moshën e pensionimit. Pozitat e lira nuk kanë mundur të plotësohen për shkak të ndryshimeve ligjore që kanë ndodhur gjatë vitit 2021. Nga gjithsej 32 pozita, 6 pozita janë të paplotësuara për shkak të problemeve me rregullativën ligjore. Pozitat e lira janë: 1. Koordinator i Programeve (udhëheqës i stafit administrativ), 2. Drejtor për Administratë dhe Financa, 3. Zyrtar i larë për përkthime, 4. Zyrtar për personel; 5. Zyrtar për ekzekutim dhe përfaqësim dhe 6. Shofer/shtëpiak.

Në funksion të zhvillimit të kapaciteteve të stafit, gjatë vitit 2021, në kuadër të IKAP kanë marrë pjesë në trajnime disa nga stafi i Akademisë për të cilat është përgatitur plani i trajnimeve, plani individual i punës nga të gjithë nëpunësit si dhe vlerësimi vjetor për arritjen e objektivave të punës.

10.2.1 Numri i punësuarve dhe nevojat për punëtorë të rinj

Në periudhën raportuese, numri i përgjithshëm i pozitave të miratuara sipas Ligjit Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2021 ka qenë 32 pozita të karrierës. Me qëllim të zbatimit të mandatit ligjor të Akademisë dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi, gjatë planifikimit buxhetor për vitin 2022-2024 është bërë kërkesë për plotësimin e pozitave të nevojshme si në vijim:

Njëmbëdhjetë (11) pozitat e kërkuara për vitin 2022 janë:

- **Zyrtar (1) për Marrëdhënie me Publikun:** Mungesa e stafit profesional në marrëdhënie me publikun ka rezultuar me prezantim jo të mjaftueshëm të punës së Akademisë si në opinionin e brendshëm ashtu edhe të jashtëm. Numri i madhë i trajnimeve, asistenca dhe partneriteti me shumë organizata si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, kërkesat e shumta nga komuniteti ligjor në vendin tonë, por edhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me Institucionet Ndërkombëtare të Trajnimeve e vënë AD-në në një pozite të vështire në lidhje me plasimin e informatave dhe mirëmbajtjen e komunikimit. Të kujtojmë, se komunikimi me opinionin e gjere do të ndikojë jashtëzakonisht shumë në ngritjen e besimit të publikut në institucionet e drejtësisë, e posaçërisht për AD-në, si një institucion profesional dhe i pavarur i mandatuar për ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës.
- **Një (1) Udhëheqës për trajnime të stafit administrativ** - Programi për trajnimin e stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive është nevojë e shprehur e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe obligim i përcaktuar me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë. Duke marrë parasysh numrin e madh të stafit mbështetës dhe atyre administrativ të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, që kalon numrin prej 1500 pjesëmarrësve potencial, Akademia e ka të

pamundur zbatimin e këtij programi për gjithë stafin mbështetës dhe atyre administrativ pa nëpunës përgjegjës për realizimin e programit të kërkuar sipas ligjit.

- **Dy (2) Zyrtar të trajnimeve** – AD ka disa programe trajnuese që ju dedikohen përfituesve të ndryshëm dhe këto programe kanë nevojë për personel shtesë profesional, për identifikim të nevojave dhe hartim të programeve adekuate, pasi që me ligjin për buxhetin e vitit 2020, AD-së i është zvogëluar stafi për dy pozita, një pozitë që ka qenë e përhershme dhe një pozitë që ka qenë e parashikuar në buxhetin e vitit 2020.
- **Tre (3) Zyrtar për publikime dhe hulumtime** - në kuadër të funksioneve ligjore të Akademisë është edhe Programi për Hulumtime dhe Publikime i cili për dallim nga programet tjera ende nuk ka arritur plotësisht objektivat e caktuara në veçanti në pjesën e hulumtimeve ngase momentalisht është vetëm, me një zyrtar. Nevoja për hulumtime ngërthen në vete një mori të aktiviteteve, sikurse monitorimi i raporteve të ndryshme në lidhje me zbatueshmërinë e legjislacionit, përcjellja e vazhdueshme e risive legjislative, monitorimi i praktikës gjyqësore si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, zhvillimi dhe ndërmarrja e aktiviteteve në vlerësimin e nevojave për trajnime, duke u bazuar në praktikën më të mira të Rrjetit Evropian të Institucioneve Trajnuese për gjyqtar dhe prokurorë dhe profesionist tjerë ligjore (EJTN, CIPOL, etj.). Shtuar edhe kompleksitetin e kuadrit ligjor të zbatueshëm në vendin tonë dhe lëmit që mbulojnë (Penale, Civile, Administrative, Kushtetuese, Kundërvajtje, Konventat e ndryshme ndërkombëtare), mbështetja edhe me 3 zyrtarë do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në ofrimin e burimeve ligjore dhe hulumtimeve për zhvillim të kapaciteteve jo vetëm të sistemit gjyqësorë dhe prokurorial, por edhe tek i gjithë sistemi i drejtësisë në Kosovë.
- **Një (1) Zyrtar për shpenzime** – mungesa e zyrtarit shpenzues vështirëson punën në kryerjen e shërbimeve financiare. Kjo pozitë është nga delegimi i shpenzime në organizatat buxhetore dhe ushtrohet nga zyrtar të Akademisë si punë shtesë.
- **Një (1) zyrtar për mësim në distancë (e-learning)** – me qëllim të mbështetjes së realizimit të trajnimeve nga distanca (e-mësimi) si një ndër format më të reja të trajnimeve të zhvilluara nga Akademia, nevojitet staf me njohuri në teknologji informative dhe njohuri në fushën juridike.
- **Dy (2) zyrtar ligjor** – Akademia e Drejtësisë nuk ka asnjë zyrtar ligjor dhe për pasojë shumë çështje ligjore me të cilat ballafaqohet Akademia nuk kush t'i trajtojë dhe mund të rezultojnë situata kur mund të vihet në pikëpyetje zbatimi i drejtë i legjislacionit në fuqi. Mbështetja e Këshillit Drejtues, Këshillit Programor, e komisioneve të AD-se, si dhe zyrës së Drejtorit Ekzekutive, me 2 zyrtar ligjor është me shume se vetëm një nevojë, pra një institucion sikurse AD pa zyrtar ligjor është e pa imagjinueshme.

10.2.2 Trajnimet e stafit

Trajnimet janë një aspekt i rëndësishëm për zhvillimin profesional të çdo zyrtari publik prandaj edhe për stafin e Akademisë së Drejtësisë janë të domosdoshme trajnimet adekuate me funksionin dhe detyrat e punës. Në funksion të kësaj, Akademia ka përfshirë stafin në trajnimet e organizuara në bashkëpunim me institucionet vendore dhe donatorët.

Bazuar në nevojat dhe kërkesat e drejtpërdrejta të nëpunësve dhe vlerësimit vjetor të punës së tyre është bërë plani i trajnimit edhe për vitin 2022. Realizimi i planit vjetor të trajnimit kryesisht varet

nga programet trajnuese të IKAP-it dhe mundësive buxhetore të Akademisë për të siguruar pjesëmarrjen e stafit në trajnime sipas kërkesave për trajnim.

10.3 Përmirësimi i infrastrukturës së AD

Gjatë vitit 2021, AD në mbështetje të Projektit EUKOJUST ka bërë vlerësimin e e ndërtesës së re të AD-së në aspektin e nevojave për hapësirë dhe funksionalitet lidhur me infrastrukturën e TIK-ut. Nga ky vlerësim kanë rezultuar propozime të aryetura për riorganizim funksional të objektit me intervenime minimale siç janë largimi i disa mureve të brendshme ndarëse dhe ndërtimi i disa të rejave për shkak se nuk ka pasur caktim të qartë të hapësirës në plan sipas funksionit, llojit të trajnimit dhe aktiviteteve tjera specifike për një institucion të trajnimit gjyqësor. Disa zgjidhje nuk i përmbushin standardet e njohura dhe janë potencialisht të rrezikshme nga këndvështrimi i sigurisë, ose nuk janë racionale në aspektin e efikasitetit të trajnimit dhe proceseve tjera të punës sipas përshkrimit të mëposhtëm. E gjithë kjo e bën të vështirë, e nganjëherë të pamundur, vlerësimin adekuat dhe planifikimin e infrastrukturës së nevojshme të TIK.

Sipas planeve, të gjitha zyrat e personelit gjenden në katin e dytë dhe të tretë. Kështu që stafi i involvuar në aktivitetet trajnuese do të jetë larg sallave të trajnimit dhe do të jetë i vështirë ofrimi i mbështetjes adekuate dhe me kohë. Zgjidhje më e mirë do të ishte vendosja e stafit të trajnimit në katin e njëjtë dhe afër sallave të trajnimit.

Shërbimet administrative të cilat pranojnë vizitorë, dërgesa, postën, furnizimet, etj. janë po ashtu të vendosur në katin e dytë/ tretë, sipas planeve. Kjo është vlerësuar e papërshtatshme për vizitorë dhe paraqet rrezik për pengesë në procesin e trajnimit nga qarkullimi i vizitorëve. Përzierja e gjyqtarëve dhe prokurorëve pjesëmarrës në trajnime me vizitorë mund të krijojë edhe një perceptim të papërshtatshmërisë. Çështja e sigurisë po ashtu nuk duhet të neglizhohet në këtë rast. Një zgjidhje më e mirë është vlerësuar do të ishte vendosja e shërbimeve administrative në katin përdhësë, afër hyrjes, së bashku me hollin ku vizitorët mund të presin duke mos e penguar procesin e trajnimit.

Po ashtu është vlerësuar se Teknologjia Informative ka nevojë për kompletim sepse në formën si është paraparë në kontratë, nuk ofron zgjidhje për të hyrë në objekt e lëre më të mendohet në afatgjatë. Më poshtë janë disa komente lidhur direkt me TI në objektin e ri.

Sistemi konferencial dhe përkthimi simultant:

- Kabinat e përkthimit në përgjithësi nuk i përmbushin kërkesat standarde (ISO 2603: 2016 dhe ISO 4043:2016) në aspektin e hapësirës dhe lokacionit.
- Mikrofonat për pjesëmarrës në numër janë shume të vogël marr parasysh numrin e madh të sallave. Për 11 salla trajnimi, numri mesatar është 17 mikrofone përfshi këtu edhe trajnuesit.

- Zerimi nëpër salla – nuk është planifikuar dhe nuk është paraparë zërim nëpër sallat e trajnimit. Sallat e trajnimit me hapësirat që janë duhet patjetër të kenë edhe zërimin. Gjithahstu ka mungese të theksuar për paisjet e përkthimit.
- Pajisjet e parapara në projekt të ndërtimit specifikojnë sistemin wireless. Ky sistem wireless është shumë i papërshtatshëm për objektin e Akademisë për shkak të numrit të madhe të sallave dhe mundësisë shumë të lehtë të interferimit të valëve mes pajisjeve me ç'rast do të vie deri të përzjerja e zërit mes sallave.
- Pajisjet nuk janë të centralizuara, nuk ka softuer të centralizuar. Si të tilla këto pajisje kërkojnë jashtëzakonisht angazhim të vazhdueshëm, mirëmbajtje të kushtueshme, burime njerëzore, hapësira të veçanta për vendosje në secilin kat, etj.

Rrjeti kompjuterik dhe telefonik

Edhe Rrjeti kompjuterik dhe telefonik kanë mangësitë të shumta. Një komunikimin në mes të Inxhinierit të projekteve elek. në DSPIMNQ - DPPS-MPB dhe Drejtorati i Rrjetave dhe Telekomunikimit – ASHI, vërtetojnë këto mangësi. Drejtorati i Rrjetave dhe Telekomunikimit – ASHI sugjerojnë që të behën ndryshime në specifikim të pajisjeve aktive për rrjetën kompjuterike dhe sistemit të telefonisë digjitale. Këto ndryshime parashihen të kenë një kosto rreth 25 500€. Vlen të ceket se në këtë projekt ASHI është konsultuar nga MPB/departamenti i inxhinieringut vetëm pasi kërkesës së Akademisë. Sa i përket rrjetit telefonik, në objektin e ri nuk është paraparë asnjë aparat telefoni VoIP që do të shërbente Akademisë për realizimin e thirrjeve telefonike.

Parkingu në objektin e ri.

Me ndërtimin e objektit të ri të Akademisë së Drejtësisë nuk është paraparë edhe ndërtimi i parkingut për pjesëmarrësit në trajnime. Vlen të ceket se parkingu për automjetet e pjesëmarrësve është thelbësor kur dihet funksioni i Akademisë dhe pjesëmarrësit janë nga të gjitha regjionet e Kosovës. Gjithashtu rruga për qasje në ndërtesë nuk është paraparë në projekt, edhe pse kjo pjesë me parking është paraparë në një projekt tjetër që do të realizohet në të ardhmen për të gjitha objektet që janë ndërtuar dhe pritet të ndërtohen.

Inventari

Me ndërtimin e objektit të ri nuk është paraparë as inventari. Objekti i ri ka hapësirë shumë më të madhe se sa objekti aktual dhe si i tillë kërkon edhe inventarin. Projekti i ndërtimit nuk ka parape specifikimet e nevojshme për inventar dhe si i tillë duhet të zhvillohet procedura shtesë për prokurorim të inventarit.

10.3.1 Planifikimi për asete të reja dhe ndërtesën e Akademisë

Një ndër kërkesat më me rëndësi për këtë vit është edhe ndërtesa e Akademisë. Akademia që nga Dhjetori i vitit 2006 është e vendosur në një ndërtesë për të cilin është detyruar të paguaj qira, në mënyrë që të vazhdoj realizimin e funksioneve ligjore.

Hapësirat e ndërtesës së Akademisë, ku është tani janë rreth 1,224.84 m². Zbatimit i të gjitha programeve trajnuese, nevojat në rritje për trajnime të specializuara, nevojat për gjithë përfshirje në trajnime, trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve fillestar, trajnimi i profesionistëve tjerë të

përcaktuar me ligj, krijimi i njësisë për hulumtime dhe bibliotekës, organizimi i konferencave dhe aktiviteteve tjera të ndryshme ka ndikuar që nevoja për hapësira të rritet.

Në vitin 2019 Akademia e Drejtësisë ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit me Ministrinë e Administratës Publike për ndërtimin e objektit të AD-së. Janë zhvilluar procedurat e tenderimit dhe ka filluar ndërtimi i objektit të Akademisë, janë duke vazhduar punimet në ndërtimin e objektit të AD-së, ku është filluar në korrik të 2019 dhe siç parashihet në kontratë punimet duhet të përfundohen brenda 36 muajve (korrik 2022).

10.4 Avancimi i teknologjisë informative

Teknologjia informarive ka qenë prioritet për AD-në veçanërisht meqenëse me rrethanat pandemike është përballë institucioni i AD-së edhe gjatë vitit 2021.-Duke pasë në konsideratë se të gjitha rajnimet dhe aktivitetet tjera të AD-së janë realizuar kryesisht përmes platformave të mësimin online ILIAS dhe Zoom i është kushtuar vëndje e veçantë stafit në procese të punës që kanë të bëjnë me teknologji informative, mirëmbajtjes dhe administrimit të vazhdueshëm të kompjuterëve, lloptopave, serverit, telefonisë fikse dhe pajisjeve tjera. Poashtu në sistemin për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese janë zhvilluar disa raporte statistikore. Këto raporte kanë lehtësuar punën e stafit të Akademisë, kanë kursyer kohën për të arrit deri te informata dhe dhënien e informatave të sakta rreth trajnimeve.

Në periudhën raportuese janë përgatitur kërkesat funksionale për sistemin për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese dhe ueb faqen e Akademisë. Divizioni i TI ka specifikuar mangësitë në këtë sistem dhe nevojën për zhvillimin e funksioneve të reja.

Ueb faqja zyrtare dhe rrjetet tjera sociale të Akademisë vazhdimisht janë freskuar me informata të reja. Ueb faqja e Akademisë ka një numër të konsiderueshëm të vizitorëve. Gjatë këtij viti mesatarisht ueb faqen e kanë vizituar rreth 1550 përdorues për një muaj. Po ashtu edhe faqja e Akademisë në rrjetin social Facebook ka arrit në mbi 3340 ndjekës.

Për herë të parë një pjesë e testit nga Programi i Trajnimit Fillestar për Gjeneratën e VIII të gjyqtarëve të sapo emëruar është organizuar në formë elektronike duke përdorur pajisjet elektronike. Divizioni i TI-së në Akademinë e Drejtësisë ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme dhe ka ofruar mbështetje për mbarëvajtje të testimit.

Për shkak të shërbimeve dhe mundësive më të mira platforma e mësimin në distancë ILIAS është zëvendësuar me platformën e mësimin në distancë Moodle.

Risi në fushën e teknologjisë informative ishte edhe paisja me 5 smartboard – display interaktivë. Këta smartboard do të mundësojnë që trajnuesi dhe pjesëmarrësi të jenë bashkëpunues në një panel dixhital, të ndajnë materiale të ndryshme dhe të diskutojnë në grup edhe në një distancë të largët fizike.

10.5 Prokurimi

Bazuar në kornizën ligjore që rregullon fushën e prokurimit, AD si institucion me më pak se 50 nëpunës nuk ka të drejtë të zhvilloj procedura të prokurimit, kompetencë kjo që është bartur tek

AQP. Megjithatë për periudhën raportuese është hartuar dhe zbatuar plani i prokurimit Janar-Dhjetor 2021 si dhe janë ekzekutuar të gjitha urdhër blerjet për shërbime dhe furnizime të ndryshme gjatë vitit.

Në periudhën raportuese aktivitetet e prokurimit të dërguara në AQP janë si në vijim:

- Furnizimi me material higjienik(maska, dezinfektues etj.)
- Dezinsektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i ndërtesës;
- Mirëmbajtja dhe servisimi i klimave;
- Mirëmbajtja dhe servisimi i veturave;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorit;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të IT.
- Sigurimi fizik i objektit;
- Shërbime të pastrimit dhe mirëmbajtjes së objektit
- Qasja dhe shfrytëzimi në platformën zoom për video komunikim;
- Shërbime të përkthimit.

Aktivitetet e prokurimit të realizuara janë si në vijim:

- Servisimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorit
- Shërbime të pastrimit dhe mirëmbajtjes së objektit
- Deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi i objektve të agjencive të pavarura
- Sigurimi fizik i objekteve të agjencive të pavarura
- Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të IT
- Servisim dhe mirëmbajtja e automjeteve
- Qasja dhe shfrytëzimi i platformës ZOOM për Video komunikim për Nevojat e Akademisë së Drejtësisë
- Shërbime të përkthimit për nevojat e Akademisë së Drejtësisë
- Furnizim me karrika për zyre për nevojat e Akademisë së Drejtësisë
- Akomodim, ushqim dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime në regjionin e Prishtinës.
- Akomodim, ushqim dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime në regjionin e Pejës
- Furnizim me inventar-tavolina pune dhe ormana.

10.6 Financat

Në kuadrin e financave janë realizuar aktivitetet si në vijim:

- Janë përgatitur pasqyrat vjetore financiare për vitin 2020;
- Është raportuar në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit të Kuvendit dhe në Komisionin për buxhet dhe Financa;
- Është përgatitur pyetësori për vetëvlerësim për vitin 2020;
- Është përgatitur rrjedha e parasë së gatshme për vitin 2021;
- Është përgatitur Korniza Afatmesme e Shpenzimeve dhe Buxheti për periudhën 2022-2024;
- Janë bërë barazimet periodike të shpenzimeve me thesar;

- Janë përgatitur raporte të ndryshme periodike financiare si dhe
- Të gjitha shpenzimet e proceduara për këtë periudhë janë regjistruar në databazën e brendshme të financave dhe në SIMFK.

Shpenzimet e krijuara gjatë kësaj periudhe janë mbuluar nga Buxheti i Republikës së Kosovës si burim kryesor financiar si dhe nga mbështetja e granteve të donatorëve.

Shpenzimet e buxhetit përfshihen në këto kategori kryesore ekonomike: pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet komunale.

Tabela në vijim pasqyron buxhetin fillestar dhe buxhetin përfundimtar për vitin 2021, duke përfshirë kategoritë ekonomike.

Buxheti dhe Shpenzimet 2021

Buxheti 2021				
Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Reduktimet dhe Kursimet Buxhetore	Buxheti Përfundimtar	Shpenzimet 2021
Pagat dhe Mëditjet	263,253.00	(50,716.82)	212,536.18	212,350.57
Mallrat dhe Shërbimet	536,015.00	(223,997.31)	312,017.69	269,210.26
Shpenzimet Komunale	16,500.00	(9,319.11)	7,180.89	7,180.89
Donacionet	-	-	15,277.80	12,081.39
Totali	815,768.00	(284,033.24)	547,012.56	500,823.11

Tabela nr. 11. Raporti i Buxheti për vitin 2021

Me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, buxheti fillestar për këtë vit ka qenë 815,768.00 euro, për të gjitha kategoritë ekonomike përfshirë këtu pagat dhe mëditje, mallrat dhe shërbimet dhe shpenzime komunale.

Totali i donacioneve të realizuara për vitin 2021 ka qenë 16,308.50 euro. Nga JUFREX donacion janë 9,468.50 euro dhe janë bartje nga viti 2020. Nga UNDP janë realizuar këtë vit donacion prej 6,840.00 euro, ndërsa nga totali i donacioneve për këtë vite janë shpenzuar 12,081.39 euro.


Me kërkesë të Ministrisë së Financave për deklaram të kursimeve për përmbylljen e vitit fiskal 2021, AD ka deklaruar si kursime buxhetore 169,500.00 euro prej te cilave 163,500.00 euro në mallra dhe shërbime dhe 6,000.00 euro në shpenzime komunale.

Ndërsa me vendime të Qeverisë së Republikës së Kosovës, buxheti është zvogëluar (reduktuar) për 114,533.24 euro, prej të cilave në kategorinë paga dhe mëditje 50,716.82 euro sipas vendimit 11/52 të datës 29.12.2021, në kategorinë mallra dhe shërbime në vlerë prej 60,497.31 euro sipas vendimit 02/48 të datës 15.12.2021 dhe në kategorinë ekonomike shpenzime komunale në vlerë prej 3,319.11 euro sipas vendimit 21/50 të datës 23.12.2021.

Buxheti përfundimtar për vitin 2021, në paga dhe mëditje është 212,350.58 euro, në mallra dhe shërbime 328,326.19 euro, prej të cilave 312,017.69 euro, nga buxheti dhe 16,308.50 euro donacionet dhe në shpenzime komunal 7,180.89 euro.


Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet	Shpenzimet në % në raport me buxhetin total	Mbetja	Perqindja	Shpërndarja e buxhetit në %
Pagat dhe Mëditjet	212,536.18	212,350.57	43.45%	186	100	40
Mallrat dhe Shërbimet	312,017.69	269,210.26	55.08%	42,807	86	59
Shpenzimet Komunale	7,180.89	7,180.89	1.47%	-	100	1
Totali	531,735	488,742	100.00%	42,993	92	100

Tabela nr. 12. Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2021




Grafikoni nr. 19 Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2021

Nga buxheti përfundimtar janë shpenzuar 488,927.32 euro apo 91.91 % e buxhetit. Pjesa e mjeteve të kursyera dhe të reduktuara nuk ka rrezikuar aktivitetet e AD-së. Këto kursime dhe reduktime janë bërë për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia COVID – 19.



Grafikoni nr. 20 Shpërndarja e buxhetit

Sipas këtij grafikoni shihet se 40% e buxhetit përfundimtar është ndarë për paga dhe mëditje 59% për mallra dhe shërbime, dhe 1% për shpenzimet komunale.



Grafikoni nr. 21. Shpenzimi i buxhetit

Në raport me shumën totale të buxhetit të shpenzuar: pagat dhe mëditjet me 43.45%, mallrat dhe shërbimet përfshihen me 55.08%, dhe shpenzimet komunale me 1.47%

Në tabelën në vazhdim përveç kategorive ekonomike shpenzimet prezantohen edhe për nënkategoritë ekonomike duke krahasuar me buxhetin e vitit për secilën nënkategori.

RAPORTI VJETOR I PUNËS 2021

